



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

SPECIFIKIME TEKNIKE

ARTIKUJT

XHUP I SHKURTËR PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

XHUP TREÇEREKSH PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

**KOSTUMI DIMËROR PËR PATRULLAT DHE MOTOÇIKLISTËT E
POLICISË SË SHTETIT**

KAPELE SPORTIVE DIMËRORE

**DORASHKA MOTOÇIKILISTI PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË
SHTETIT**

**XHUP ME VIZIBILITET TË LARTË PËR PUNONJËSIT E POLICISË
SË SHTETIT**

MUSHAMA SHIU PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

Specifikimet Teknike të artikujve të mësipërm janë hartuar në përputhje me V.K.M-në Nr.55 dt.27.01.2016 dhe V.K.M-në Nr.287 dt.10.05.2019. Këto Specifikime Teknike parashtrojnë në mënyrë të detajuar kërkesat themelore teknike të domosdoshme për ndërtimin e prototipit dhe prodhimin e artikullit.


Specifikimet Teknike përcaktojnë gjithashtu edhe kërkesat teknike të aksesorëve që duhet të shoqërojnë artikullin.

Prodhuesit janë të detyruar që t'i zbatojnë të gjitha specifikimet teknike të këtij dokumenti.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Xhup i shkurtër

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *xhup i shkurtër* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Pesha	250 - 300 gr/m ²		
Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349		
	Shtresa e jashtme	tekstil i endur	
	Thurja	Diagonal 2/2	
	Përbërja	100 % poliestër	
	Ngjyra	blu e errët (evening blue)	
	Shtresa e brendshme	Membranë	
	Përbërja	100 % Polytetrafluoroethylene (PTFE)	
	Shtresa e tretë	trikot	
	Përbërja	100 % poliestër	
Përshkueshmëria e ujit	Ngjyra	blu e errët	
	mbi 10,000 mm		
	Fillestare	≥ ISO 5	
Përshkueshmëria e ujit (presioni hidrostatik)	pas 3 larjeve në 40°C		≥ ISO 3
	mbi 50 mbar/min		
Aftësia ajërosëse e tekstilit	mbi 10,000 gr/m ² /24h	ajrosje e mirë	Ret ≤ 7 m ² Pa/W
Rezistenca termike	≥ 0.030 m ² K/W		
Përshkueshmëria e ajrit	≤ 5 l/m ² /s		
Qëndrueshmëria në tërheqje	baza	≥ 750 N	indi ≥ 600 N
Qëndrueshmëria në grisje	baza	≥ 65 N	indi ≥ 65 N
Stabiliteti dimensional	± 3% në bazë dhe në ind		
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.	
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.	
Rezistenca ndaj hidrokarbureve (padepërtueshmëria ndaj vajërave)	Fillestare ≥ 5 Pas 3 larjesh ≥ 4 (temp 40 °C; tharje ne ajër)		
Rezistenca ndaj delaminacionit (pas 30 cikle larjesh)	Nuk ka delaminacion, vrima apo flluska më të mëdha se 3 mm		
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 50,000 cikle		
Efekti pilling (kokërzimi)	nota 5		
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm		
pH	4.0 - 9.0		

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstileve të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme* – nota 4 dhe *shumë e qëndrueshme* – nota 5. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se* – nota 6; *shumë e mirë*.


Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu të errët do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu nuk njollos tekstilin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (*kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse*):

- elementë *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesoret që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *xhup i shkurtër*:

Astarët		
Astar me mbushje me filtër për jakën, trupin dhe mëngët e xhupit për astarin e lëvizshëm të xhupit. 	Shtresa e jashtme	
	Përbërja	100% poliestër
	Thurja	diagonale
	Pesha	90 gr/m ²
	Ngjyra	blu e errët
	Mbushja	
	Përbërja	100% fibra poliestër
	Pesha	100 gr/m ²
	Shtresa e brendshme	
	Përbërja	100% poliestër
	Thurja	e trikotuar dhe e dërstiluar
	Pesha	250 gr/m ²
	Ngjyra	blu e errët
	Përbërja	90% poliestër 10% <i>spandex</i>
	Pesha:	90 gr/m ²

		Ngjyra	blu e errët	
Astar për mëngët dhe xhepat.	Përbërja	50% pambuk	50% poliestër	
	Pesha	80 gr/m ²		
	Ngjyra	blu e errët		
	Thurja	diagonale		
Përforcues				
Frazelinë termoadezive me ngjyrë të errët për jakën, kapakët e xhepave, kapakët e mëngëve, bordurën e poshtme të xhupit dhe spaletat.				
Aksesorë të tjerë				
	Fileto cilindrike prej materiali reflektiv.			
	Materiali duhet të rezistojë mbi 105 cikle të larjes në temperaturë 60° C.			
	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit EN ISO 20471:2013			
	Gjerësia e filetos (e qepur)		0.4–0.5 cm	
	Përbërja	100% poliestër		
	Ngjyra	gri argjend		
Element <i>Velcro</i> femër për gjoksin, mëngët dhe <i>Velcro</i> femër/mashkull për kapakët e mëngëve.	Përmasat <i>Velcro</i> , gjoksit		8.6 x 3 cm	
	Përmasat <i>Velcro</i> , mëngët		7 x 8 cm	
	Përmasat <i>Velcro</i> , gjuhëzat e kapakëve		2 x 13 cm	
	Përbërja		100% fibra poliamide	
	Trashësia		2.2 mm	
	Masa lineare		41 g/m ± 5%	
	Ngjyra		njësoj si tekstili	
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme			
	E ftohtë		- 30° C	
	E nxehtë	pika e dobësimit		180° C
pika e shkrirjes		210–250° C		
	Qëndrueshmëria e ngjyrës			
	Në larje		jo më pak se 3	
	Në ujë të nxehtë			
	Në djersë			
	Në fërkim			
Llastik i gjerë për pjesën e poshtme të xhupit	Përbërja		100 % poliestër	
	Ngjyra		e zezë	

	Gjerësia	5 cm
Shirit për termosaldimin e disa qepjeve të xhupit. Shirit për termosaldimin e qepjeve 	Me 3 shtresa	poliamid PTFE shtresë termoadezive
	Ngjyra	e zezë
	Gjerësia	2 cm
	Trashësia	0.35 mm
	Me ajërosje të mirë dhe rezistencë të lartë ndaj ujit.	
Filli		
Fill qepës për qepjet primare dhe të dukshme.	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	50 Nm
	Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes	jo më pak se 12 N
	Ngjyra	njësoj si xhupi
Fill qepës për qepjet dytësore (astari i xhepave, astarët e xhupit etj.).	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	75 Nm ± 5%
	Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes	jo më pak se 12 N
	Ngjyra	njësoj si xhupi
Perçinat		
	6 copë Nr. 27 (d 17 mm) + 1 rezervë	
	Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri)
	Ngjyra	e zezë pa shkëlqim
	<i>Kujdes! Perçina duhet të jetë e përshtatshme për tekstin e produktit ku do të montohen.</i>	
Zinxhirat		
Zinxhir për mbylljen e xhupit. 	Standard, me fund të hapur, me rezistencë maksimale ndaj ujit.	
	Madhësia e dhëmbëzave	8 VS ose 10VF
	Shiriti prej tekstili	100% poliestër
	Dhëmbët	100% acetal
	Ngjyra	blu e errët
Zinxhir me fund të hapur, për montimin dhe çmontimin e astarit me mbushje.	Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur.	
	Montimi në xhup	Në anën e djathtë të veshur
	Madhësia e dhëmbëve	4 CF ose 5 CF

	Shiriti prej tekstili	100% poliester
	Dhëmbët	100% poliester monofilament
	Ngjyra	blu e errët
Zinxhir me fund të hapur, për montimin-çmontimin dhe mbylljen e astarit me mbushje.		Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur, dhe me kokë të rrotullueshme.
	Montimi në xhup	Në anën e majtë të veshur
	Madhësia e dhëmbëve	4 CF ose 5 CF
	Shiriti prej tekstili	100% poliester
	Dhëmbët	100% poliester monofilament
	Ngjyra	blu e errët
Zinxhir për xhepat e brendshëm të xhupit.		Standard, me fund të mbyllur
	Madhësia e dhëmbëve	4 CF ose 5 CF
	Shiriti i zinxhirit	100% poliester
	Dhëmbët e zinxhirit	100% poliester monofilament
	Ngjyra	blu e errët
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për identifikimin e fabrikës, masës, gjinisë, mirëmbajtjes dhe përbërjes.	Përbërja	100% poliester
	Ngjyra	e bardhë
Stampa		
	Shkrimi POLICIA, mbrapa në xhup	
	Stampim me material/bojë reflektive	
	Ngjyra	gri, argjend
	Përmasat referencë	11 x 38 cm
	Lloji i germës	Myriad Pro Bold
Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjesh.		

d. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *xhup i shkurtër*

1 qese polietileni për xhup
1 qese polietileni për perçinën rezervë
1 kuti kartoni për paketimin e xhupave

Të gjithë mjetet dhe aksesoret mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *xhup i shkurtër* do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS – XXXL për femra dhe S – XXXL për meshkuj, dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



Meshkuj			Femra		
2	Perimetri i qafës	cm.	2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.	3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.	4	Perimetri i krahavorit (poshtë gjoksti)	cm.
5	Perimetri në pjesën e barkut	cm.	5	Perimetri i belit	cm.
6	Perimetri i muskullit të krahut	cm.	6	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
7	Perimetri i kyçit të dorës	cm.	7	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
10	Gjatësia e plotë	cm.	8	Lartësia nga supi në gjoks	cm.
11	Lartësi e përgjithshme e trupit mbrapa (nga supi në tokë)	cm.	10	Perimetri i krahut	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale deri tek vija e belit)	cm.	11	Perimetri i kyçit të dorës	cm.
13	Gjatësia e mes shpatullave	cm.	12	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.
14	Gjatësia nga supi tek bërryli	cm.	13	Lartësia nga vija e belit në vijën e kockës abdominale	cm.
15	Gjatësia e krahut, nga supi tek kyçi i dorës	cm.	14	Lartësia e pjesës abdominale (nga vija e belit në vijën e vitheve)	cm.
16	Lartësia e pjesës nga vija e supit tek vija e belit	cm.	17	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
			18	Lartësi e përgjithshme e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në tokë)	cm.
			19	Gjatësia e supit	cm.
			20	Gjatësia nga supi në bërryl	cm.
			21	Gjatësia e krahut, nga supi në kyçin e dorës.	cm.
			25	Gjatësia e personit	cm.

3. NGJYRAT REFERENCE

Ngjyra blu spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349 për tekstilin bazë të xhupit, astarëve, zinxhirëve dhe elementëve *velcro*.

Ngjyra gri e argjendtë spektri sipas CIELCH 73, 0.743, 200.028, për stampën dhe elementët reflektivë.

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.



Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *xhup i shkurtër*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 80 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Aplikimi i frazelinës

Ngjitja e frazelinës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën 130–140 °C, me kohëzgjatje 8–10 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet aplikimi i frazelinës me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

5. NDËRTIMI I XHUPIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të xhupit

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.




Xhupat për femra dhe për meshkuj duhet të jenë identikë në tekstil dhe ngjyrë përveç modelimit që duhet të jetë sipas gjinisë.

Pjesët përbërëse të xhupit:

- Jaka
- Dy pjesët e përparme
- Dy pjesët e pasme
- Bordura e poshtme
- Dy xhepa të përparmë
- Mëngët
- Kapakët e mëngëve
- Spaletat

JAKA



Jaka e xhupit duhet të jetë në formë rrethore, rreth 6 cm e lartë. Ajo duhet të përbëhet nga dy shtresa me tekstil të njëjtë (si xhupi), e përforcuar me frazelinë termoadezive.

Buzët e jakës duhet të përshkohen nga tegela lineare perimetrale një gjilpërësh sipërfaqësorë: një tegel në buzën e sipërme dhe dy tegela në buzën e poshtme.


Mbyllja e jakës duhet të bëhet me gjuhëz, me anë të dy perçinave metalike.

PJESËT E PËRPARME

Mbyllja e xhupit duhet të bëhet me anë të zinxhirit. Në brendësi zinxhiri duhet të ketë fileto për t'u mbrojtur nga era.

Buzët e përparme të xhupit (tek mbyllja) duhet të përshkohen nga një tegel linear vertikal një gjilpërësh sipërfaqësor.


XHEPAT E PËRPARMË



Xhupi duhet të pajiset me dy xhepa të jashtëm me kapak dhe fileto. Kapakët dhe filetот duhet të përbëhen nga dy shtresa me tekstil të njëjtë (si xhupi), të përforcuara me frazelinë termoadezive.

Buzët e lira të kapakëve, buzët anësore të filetove dhe tekstili sipër kapakut duhet të përshkohen nga tegela lineare perimetrale një gjilpërësh sipërfaqësorë. Hapja e xhepit duhet të jetë 18 cm e gjerë.

Mbyllja e xhepave duhet të bëhet me perçinë metalike.



Përmasat referencë	A	B	C	D
Xhepat	18 cm	5.5 cm	18 cm	2 cm

PJESËT E PASME


Mbrapa xhupi duhet të përbëhet nga dy pjesë të qepura me njëra tjetrën me tegel linear një gjilpërësh: pjesa e shpatullave dhe pjesa e shpinës. Bashkë me tegelin qepës duhet të qepet edhe filetoja cilindrike reflektive/dekorative.

Në distancë 1 mm mbi tegelin qepës duhet qepur një tjetër tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

BORDURA E POSHTME

Në pjesën e poshtme xhupi duhet të përfundojë me një bordurë rreth 5 cm të lartë. Bordura duhet të përbëhet nga dy shtresa tekstili të njëjtë (si xhupi) të përforcuara nga brenda me frazelinë termoadezive. Tek dy pjesët anësore (në të majtë dhe në të djathtë), bordura duhet të jetë e pajisur me llastik.

SPALETAT



Spaletat duhet të jenë drejtkëndore në njërën anë dhe me kulm (me formë shigjete) në anën tjetër. Ana drejtkëndore duhet të qepet tek tegeli i rrethit të mëngës (gavatura). Katër brinjët e tjera përshkohen nga një tegel perimetral sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 5 mm nga buza.


Spaleta duhet të ndërtohet me dy shtresa tekstili ngjyrë blu (njësoj si xhupi) me përmasa të njëjta. Shtresa e sipërme e spaletës duhet të përforcohet me frazelinë termoadezive.

Perçina duhet të jetë në anën e "shigjetës", distancë rreth 1.5 cm nga kulmi.

Perçina duhet të qepet në të njëjtin pozicion tek supi i xhupit. Perçina duhet të jetë me diametër 17 mm, metalike, ngjyrë të zezë.

Gjatësia e spaletës duhet të ndryshojë në varësi të masës së xhupit. Gjatësia e spaletës duhet të rritet me 2–3 mm për çdo masë. Përmasat bazë duhet të jenë këto: 13.5 x 4.8 cm për masën më të vogël të xhakëtës dhe 18 x 4.8 cm për masën më të madhe të xhupit.

MËNGËT



Mëngët duhet të ndërtohen me dy pjesë gjatësore, të cilat duhet të qepen me njëra-tjetrën me tegela linearë një gjilpërësh: një tegel gjatësor tek aksi vertikal i sqetullës dhe një tegel gjatësor tek aksi vertikal i bërrylit. Bashkë me tegelin e aksit të bërrylit duhet të qepet edhe filetoja cilindrike reflektive/dekorative.

Tegeli tek aksi i bërrylit duhet të lidhet me tegelin e pjesëve të pasme të xhupit, në mënyrë që të formohet një linjë e vetme dekorative.

Në distancë 1 mm mbi tegelin qepës duhet qepur një tjetër tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Manshetat. Në fund mëngët duhet të mbyllen me mansheta në formë bordure me lartësi rreth 4 cm. Manshetat duhet të përbëhen nga dy shtresa tekstili të njëjtë (si xhupi) të përforcuara nga brenda me frazelinë termoadezive.

Kapakët duhet të pajisen me gjuhëz me elementëve *Velcro* për të shtrënguar mëngën.

Buzët e lira të manshetave duhet të përshkohen nga një tegel perimetral linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

ASTARI

Xhupi duhet të vishet tek pjesa e trupit me astar në formë rrjete dhe tek mëngët me astar prej tekstili. Astar duhet të qepet tek paramontura.

ASTARI I LËVIZSHËM

Xhupi (me gjithë mëngët) duhet të pajiset me astar tjetër të lëvizshëm me mbushje që mund të montohet tek xhupi.

Astar i lëvizshëm duhet të shërbejë edhe si xhup i lehtë pranveror. Ai duhet të montohet në xhup me anë të zinxhirit të astarit të lëvizshëm dhe zinxhirëve të montuar në brendinë e xhupit.



Zinxhiri i astarit të lëvizshëm duhet të shkojë deri në fund të jakës. Koka e zinxhirit të astarit të lëvizshëm duhet të jetë e rrotullueshme, me përdorim të dyanshëm.

Astar i lëvizshëm duhet të përbëhet nga tre shtresa: shtresa e jashtme prej tekstili methurje diagonale, mbushja me fibra poliestre dhe shtresa e brendshme (në kontakt me trupin) prej tekstili të trikotuar dhe dërstiluar.

Përveç qepjes perimetrale, shtresat duhet të qepen me njëra tjetrën edhe me anë të tegelave linearë një gjilpërësh që krijojnë motive me rombe në të gjithë sipërfaqen. Përmasat e rombeve duhet të jenë përafërsisht 5 x 5 cm.

Jaka e astarit duhet të jetë në formë rrethore, rreth 4 cm e lartë.


Astari i brendshëm i lëvizshëm



Me astar të mbushur, për kohë të ftohtë



Me astar prej rrjete, për kohë të ngrohtë



Zinxhir plastik me dhembësa spirale

Xhepat e brendshëm. Xhupi duhet të pajiset me dy xhepa të brendshëm me zinxhir 17 cm të gjatë, një xhep në të majtë dhe një në të djathtë. Filetot e xhepave duhet të jenë me tekstil të njëjtë si xhupi. Xhepat e brendshëm duhet të qepen tek astari prej rrjete.

Astari i xhepave të brendshëm duhet të jetë i njëjtë me astarin e mëngëve. Përmasat e astarit duhet të jenë 18 x 23 cm.

Xhepi i brendshëm



SHKRIMI POLICIA MBRAPA

Për xhupin e masës M



Në pjesën e pasme të xhupit, në shpinë, duhet të stampohet shkrimi POLICIA. Shkrimi duhet të jetë i vendosur në distancë rreth 2 cm poshtë filetos cilindrike.

Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i gërmës.

Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i gërmës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampa duhet të jetë reflektive me ngjyrë gri. Stampa duhet të jetë e cilësisë së parë dhe të mos e humbasë efektin reflektiv gjatë përdorimit. **Kujdes!** Përmasat e stampës mund të ndryshojnë (proporcionalisht) tek masat e vogla dhe tek masat e mëdha.


VELCRO


Xhupi duhet të pajiset me tre elementë *Velcro* femër:

- 1 copë për vendosjen e gradës së gjoksit/ numrit të identifikimit me përmasa 8.6 x 3 cm.
- 1 copë për vendosjen e stemës së policisë në mëngën e majtë me përmasa 7 x 8 cm.
- 1 copë për vendosjen e shenjave në mëngën e djathtë me përmasa 7 x 8 cm.

Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel zig-zag perimetral me ngjyrë blu dhe të përforcohen me dy tegela diagonale. Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e shtresës përforcuese prej frazeline në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstit gjatë qepjes dhe përdorimit.

Elementët *Velcro* në mëngë duhet të ketë një distancë rreth 6 cm nga gavatura e mëngës.





Kujdes! Elementët Velcro për mëngën e djathtë duhet të priten në përputhje me shërbimet që kryen punonjësi i policisë. Kufiri i lejuar i gabimit për elementët Velcro është ± 1 mm.

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së xhupit duhet të jenë me hap 4 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
 - Tegelat qepës tek gavaturat e mëngëve, pjesa e supeve, para dhe mbrapa trupit duhet të jenë të termosaldura.
- Të gjithë elementët e xhupit duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili i xhupit nuk duhet të krijojë rrudha gjatë përdorimit.
- Xhupi duhet të jetë i lehtë për tu mirëmbajtur.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e xhupit është $\pm 2\%$.
- Vendosja e perçinave në xhup duhet të bëhet rreptësisht sipas përshkrimit tek *Specifikimet Teknike*.
- Perçinat duhet të kenë pamje të rregullt. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishen ose të pësojnë dëmtime të tjera.
- Elementëve Velcro nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.

- Tekstilet, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Artikulli *xhup i shkurtër* duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, gjinia, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Tek xhepi i brendshëm i djathtë (i veshur) duhet të qepet një etiketë.

Perçina rezervë duhet të vendoset në një qese plastike polietileni ose prej kartoni të hollë, të mbyllur mirë. Perçina rezervë duhet të jetë e pranishme tek secili xhup. Ajo duhet të vendoset gjatë paketimit në etiketën e xhupit me një fije plastike të siguruar mirë.

Në momentin e dorëzimit xhupat duhet të jenë të pastër, të hekurosur dhe pa njolla. Xhupat e palosur duhet të futen në qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen xhupa të së njëjtës masë dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë një sasi të barabartë xhupash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e xhupit, gjinia, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjës (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes. EN ISO 2286-2:2016 Tekstile të gomuar ose të plastifikuara - Pjesa 2: Metodat për përcaktimin e masës së përgjithshme për njësi të sipërfaqes, masës për njësi të veshjes të sipërfaqes dhe masës për njësi të shtresave
Përshkueshmëria e ujit	EN ISO 4920:2012

(presioni hidrostatik)	Pëlhura tekstili - Përcaktimi i qëndrueshmërisë në njomjen sipërfaqësore (prova me sprucim) EN ISO 6330:2012 Tekstile - procedurat e larjes dhe tharjes në kushte shtëpie për testimin e tekstileve EN 20811/ EN ISO 811:2018 Tekstile - përcaktimi i qëndrueshmërisë ndaj depërtimit të ujit - testi nën presionin hidrostatik
Aftësia ajërosëse e tekstilit	EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike në ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga djersitja)
Rezistenca termike	EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike në ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga djersitja)
Përshkueshmëria e ajrit	EN ISO 9237 :1995 Tekstilet - Përcaktimi i depërtueshmërisë së pëlhurave nga ajri
Qëndrueshmëria në tërheqje	EN ISO 1421:2016 Tekstile të gomuara ose të plastifikuara - Përcaktimi i forcës tërheqëse dhe zgjatimit në këputje
Qëndrueshmëria në grisje	EN ISO 4674-1 (A):2016 Tekstile të gomuara ose të plastifikuara -Përcaktimi i qëndrueshmërisë në grisje - Pjesa 1: Shkalla konstante e metodave të grisjes
Stabiliteti dimensional	EN ISO 3175: 2018 Tekstile - Kujdesi profesional, pastrimi i thatë dhe me lagështi i pëlhurave dhe veshjeve - Pjesa 1: Vlerësimi i performancës së provës pas pastrimit dhe procesit përfundimtar
	EN ISO 3759:2011 Tekstilet - Përgatitja, markimi dhe matja e kampioneve të pëlhurave dhe të veshjeve në provat për përcaktimin e ndryshimit të përmasave
	EN ISO 5077:2007 Tekstile - Përcaktimi i ndryshimit në larje dhe në tharje
	EN ISO 6330:2012 (6N) Tekstile - Procedurat e larjes dhe tharjes në kushte shtëpie për testimin e tekstileve
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi.
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit


	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Rezistenca ndaj hidrokarbureve (padepërtueshmëria ndaj vajërave)	EN ISO 14419:2010 Tekstilet- Padepërtueshmëria ndaj vajërave- Testi i rezistencës ndaj hidrokarbureve
Rezistenca ndaj delaminacionit (pas 30 cikle larjesh)	EN ISO 6330:2012 (A1, 4N) Tekstile - Proçedurat e larjes dhe tharjes në kushte shtëpie për testimin e tekstileve
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Materialet reflektive	EN ISO 20471: 2013/ A1:2016 Standardi për shiritat reflektive dhe veshjet për sigurinë në punë.
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Xhup treçereksh

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *xhup treçereksh* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Pesha	250 - 300 gr/m ²		
Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349		
	Shtresa e jashtme	tekstil i endur	
	Thurja	Diagonal 2/2	
	Përbërja	100 % poliestër	
	Ngjyra	blu e errët (evening blue)	
	Shtresa e brendshme	Membranë	
	Përbërja	100 % Polytetrafluoroethylene (PTFE)	
	Shtresa e tretë	trikot	
	Përbërja	100 % poliestër	
	Ngjyra	blu e errët	
Përshkueshmëria e ujit	mbi 10,000 mm		
	Fillestare	≥ ISO 5	
	pas 3 larjeve në 40°C	≥ ISO 3	
Përshkueshmëria e ujit (presioni hidrostatik)	mbi 50 mbar/min		
Aftësia ajërosëse e tekstilit	mbi 10,000 gr/m ² /24h	ajrosje e mirë	Ret ≤ 7 m ² Pa/W
Rezistenca termike	≥ 0.030 m ² K/W		
Përshkueshmëria e ajrit	≤ 5 l/m ² /s		
Qëndrueshmëria në tërheqje	baza	≥ 750 N	indi ≥ 600 N
Qëndrueshmëria në grisje	baza	≥ 65 N	indi ≥ 65 N
Stabiliteti dimensional	± 3% në bazë dhe në ind		
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.	
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.	
Rezistenca ndaj hidrokarbureve (padepërtueshmëria ndaj vajërave)	Fillestare ≥ 5 Pas 3 larjesh ≥ 4 (temp 40°C; tharje ne ajër)		
Rezistenca ndaj delaminacionit (pas 30 cikle larjesh)	(pas	Nuk ka delaminacion, vrima apo flluska më të mëdha se 3 mm	
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 50,000 cikle		
Efekti pilling (kokërzimi)	nota 5		
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm		
pH	4.0 - 9.0		

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstileve të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron ofertën teknike të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se – nota 6; shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në ofertën teknike do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu të errët do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu nuk njollos tekstilin e bardhë.


Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elementë Velcro që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesoret që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit xhup treçereksh:

Astarët		
Astar me mbushje me filtër për trupin dhe mëngët e xhupit. 	Shtresa e jashtme	
	Përbërja	100% poliester
	Thurja	diagonale
	Pesha	90 gr/m ²
	Ngjyra	blu e errët
	Mbushja	
	Përberja	100% fibra poliester
	Pesha	100 gr/m ²
	Shtresa e brendshme	
	Përbërja	100% poliester
	Thurja	e trikotuar dhe e derstiluar
	Pesha	250 gr/m ²
	Ngjyra	blu e errët
Astar i derstiluar për pjesën e brendshme të jakës.	Përbërja	100% poliester
	Thurja	e trikotuar dhe e derstiluar

	Pesha	250-260 gr/m ²	
	Ngjyra	blu e errët	
	Përbërja	50% pambuk	50% poliester
	Pesha	80 gr/m ²	
Astar për xhepat	Ngjyra	blu e errët	
	Thurja	diagonale	
Përforcues			
Frazelinë termoadezive me ngjyrë të errët për jakën, kapakët e xhepave, kapakët e mëngëve, bordurën e poshtme të xhupit dhe spaletat.			
Aksesorë të tjerë			
	Fileto cilindrike prej materiali reflektiv		
	Materiali duhet të rezistojë mbi 105 cikle të larjes në temperaturë 60° C.		
	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit EN ISO 20471:2013		
	Gjerësia e filetos (e qepur)	0.4–0.5 cm	
	Përbërja	100% poliester	
	Ngjyra	gri, argjend	
	Përbërja	100 % poliester	
	Ngjyra	e zezë	
Llastik i gjerë për në pjesën e pasme të xhupit.	Gjerësia	5 cm	
	Përmasat <i>Velcro</i> , gjoksit	8.6 x 3 cm	
	Përmasat <i>Velcro</i> , mëngët	7 x 8 cm	
	Përmasat <i>Velcro</i> , gjuhëzat e kapakëve	2 x 13 cm	
	Përmasat <i>Velcro</i> , xhepi i shpatullave	1.5 x 2.5 cm	
	Përbërja	100% fibra poliamide	
	Trashësia	2.2 mm	
	Masa lineare	41 g/m ±3%	
Ngjyra	njësoj si tekstili		
Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme			
E ftohtë	- 30° C		
E nxehtë	pika e dobësimit	180° C	
	pika e shkrirjes	210 – 250° C	
Qëndrueshmëria e ngjyrës			
Në larje	jo më pak se 3		
Në ujë të nxehtë			
Në djersë			
Në fërkim			

Llastik tubolar (kordon) me mekanizëm shtrëngues për tu vendosur në pjesën e poshtme të xhupit. 	<table border="1"> <tr><td colspan="2">Kordoni prej llastiku</td></tr> <tr><td>Përbërja</td><td>100 % poliestër</td></tr> <tr><td>Ngjyra</td><td>e zezë</td></tr> <tr><td>Diametri</td><td>0.5 cm</td></tr> <tr><td colspan="2">Mekanizmi shtrëngues</td></tr> <tr><td>Përbërja</td><td>100% acetal</td></tr> <tr><td>Ngjyra</td><td>e zezë</td></tr> <tr><td colspan="2">Mekanizmi shtrëngues duhet të jetë i përshtatshëm për diametrin e llastikut tubolar.</td></tr> </table>	Kordoni prej llastiku		Përbërja	100 % poliestër	Ngjyra	e zezë	Diametri	0.5 cm	Mekanizmi shtrëngues		Përbërja	100% acetal	Ngjyra	e zezë	Mekanizmi shtrëngues duhet të jetë i përshtatshëm për diametrin e llastikut tubolar.	
Kordoni prej llastiku																	
Përbërja	100 % poliestër																
Ngjyra	e zezë																
Diametri	0.5 cm																
Mekanizmi shtrëngues																	
Përbërja	100% acetal																
Ngjyra	e zezë																
Mekanizmi shtrëngues duhet të jetë i përshtatshëm për diametrin e llastikut tubolar.																	
Shirit për termosaldimin e disa qepjeve të xhupit.  Shirit për termosaldimin e qepjeve	<table border="1"> <tr><td rowspan="3">Me 3 shtresa</td><td>poliamid</td></tr> <tr><td>PTFE</td></tr> <tr><td>shtresë termoadezive</td></tr> <tr><td>Ngjyra</td><td>e zezë</td></tr> <tr><td>Gjerësia</td><td>2 cm</td></tr> <tr><td>Trashësia</td><td>0.35 mm</td></tr> <tr><td colspan="2">Me ajërosje të mirë dhe rezistencë të lartë ndaj ujit.</td></tr> </table>	Me 3 shtresa	poliamid	PTFE	shtresë termoadezive	Ngjyra	e zezë	Gjerësia	2 cm	Trashësia	0.35 mm	Me ajërosje të mirë dhe rezistencë të lartë ndaj ujit.					
Me 3 shtresa	poliamid																
	PTFE																
	shtresë termoadezive																
Ngjyra	e zezë																
Gjerësia	2 cm																
Trashësia	0.35 mm																
Me ajërosje të mirë dhe rezistencë të lartë ndaj ujit.																	
Fill qepës për qepjet primare dhe të dukshme.	<table border="1"> <tr><td colspan="2">Filli</td></tr> <tr><td>Përbërja</td><td>100% poliestër</td></tr> <tr><td>Numri metrik</td><td>50 Nm</td></tr> <tr><td>Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes</td><td>jo më pak se 12 N</td></tr> <tr><td>Ngjyra</td><td>njësoj si xhupi</td></tr> </table>	Filli		Përbërja	100% poliestër	Numri metrik	50 Nm	Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes	jo më pak se 12 N	Ngjyra	njësoj si xhupi						
Filli																	
Përbërja	100% poliestër																
Numri metrik	50 Nm																
Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes	jo më pak se 12 N																
Ngjyra	njësoj si xhupi																
Fill qepës për qepjet dytësore (astari i xhepave, astarët e xhupit etj.).	<table border="1"> <tr><td colspan="2">Filli</td></tr> <tr><td>Përbërja</td><td>100% poliestër</td></tr> <tr><td>Numri metrik</td><td>75 Nm</td></tr> <tr><td>Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes</td><td>jo më pak se 12 N</td></tr> <tr><td>Ngjyra</td><td>njësoj si xhupi</td></tr> </table>	Filli		Përbërja	100% poliestër	Numri metrik	75 Nm	Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes	jo më pak se 12 N	Ngjyra	njësoj si xhupi						
Filli																	
Përbërja	100% poliestër																
Numri metrik	75 Nm																
Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes	jo më pak se 12 N																
Ngjyra	njësoj si xhupi																
Perçina 	<table border="1"> <tr><td colspan="2">13 copë Nr. 27 (d 17 mm) + 1 rezervë</td></tr> <tr><td>Përbërja</td><td>tunxh (aliazh zinku dhe bakri)</td></tr> <tr><td>Ngjyra</td><td>e zezë pa shkëlqim</td></tr> <tr><td colspan="2"><i>Kujdes! Perçina duhet të jetë e përshtatshme për tekstin e produktit ku do të montohen.</i></td></tr> </table>	13 copë Nr. 27 (d 17 mm) + 1 rezervë		Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri)	Ngjyra	e zezë pa shkëlqim	<i>Kujdes! Perçina duhet të jetë e përshtatshme për tekstin e produktit ku do të montohen.</i>									
13 copë Nr. 27 (d 17 mm) + 1 rezervë																	
Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri)																
Ngjyra	e zezë pa shkëlqim																
<i>Kujdes! Perçina duhet të jetë e përshtatshme për tekstin e produktit ku do të montohen.</i>																	
Zinxhirat Zinxhir për mbylljen e xhupit.  Zinxhir me xhepat e brendshëm të xhupit.	<table border="1"> <tr><td colspan="2">Standard, me fund të hapur, me rezistencë maksimale ndaj ujit</td></tr> <tr><td>Madhësia e dhëmbëzave</td><td>8 VS ose 10VF</td></tr> <tr><td>Shiriti prej tekstili</td><td>100% poliestër</td></tr> <tr><td>Dhëmbët</td><td>100% acetal</td></tr> <tr><td>Ngjyra</td><td>blu e errët</td></tr> <tr><td colspan="2">Standard, me fund të mbyllur</td></tr> </table>	Standard, me fund të hapur, me rezistencë maksimale ndaj ujit		Madhësia e dhëmbëzave	8 VS ose 10VF	Shiriti prej tekstili	100% poliestër	Dhëmbët	100% acetal	Ngjyra	blu e errët	Standard, me fund të mbyllur					
Standard, me fund të hapur, me rezistencë maksimale ndaj ujit																	
Madhësia e dhëmbëzave	8 VS ose 10VF																
Shiriti prej tekstili	100% poliestër																
Dhëmbët	100% acetal																
Ngjyra	blu e errët																
Standard, me fund të mbyllur																	

	Madhësia e dhëmbëve	4 CF ose 5 CF
	Shirit prej tekstili	100% poliestër
	Dhëmbët	100% poliestër monofilament
	Ngjyra	blu e errët
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për identifikimin e fabrikës, masës, gjinisë, mirëmbajtjes dhe përbërjes.		Përbërja
		100% poliestër
		Ngjyra
		e bardhë
Stampa		
	Shkrimi POLICIA, mbrapa në xhup	Stampim me material/bojë reflektive
		Ngjyra
		gri, argjend
		Përmasat referencë
		11 x 38 cm
		Lloji i germës
		Myriad Pro Bold
Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjeje.		

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *xhup treçereksh*:

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.

	
1 qese polietileni për xhup	
1 qese polietileni për perçinën rezervë	
1 kuti kartoni për paketimin e xhupave	

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *xhup treçereksh* do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS – XXXL për femra dhe S – XXXL për meshkuj, dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



Meshkuj			Femra		
2	Perimetri i qafës	cm.	2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.	3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.	4	Perimetri i krahavorit (poshtë gjoksti)	cm.
5	Perimetri në pjesën e barkut	cm.	5	Perimetri i belit	cm.
6	Perimetri i muskullit të krahut	cm.	6	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
7	Perimetri i kyçit të dorës	cm.	7	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
10	Gjatësia e plotë	cm.	8	Lartësia nga supi në gjoks	cm.
11	Lartësi e përgjithshme e trupit mbrapa (nga supi në tokë)	cm.	10	Perimetri i krahut	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale deri tek vija e belit)	cm.	11	Perimetri i kyçit të dorës	cm.
13	Gjatësia e mes shpatullave	cm.	12	Lartësia perpara nga supi ne vijën e belit	cm.
14	Gjatësia nga supi tek bërryli	cm.	13	Lartësia nga vija e belit ne vijën e kockës abdominale	cm.
15	Gjatësia e krahut, nga supi tek kyçi i dorës	cm.	14	Lartësia e pjesës abdominale (nga vija e belit ne vijën e vitheve)	cm.
16	Lartësia e pjesës nga vija e supit tek vija e belit	cm.	17	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
			18	Lartësi e përgjithshme e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në tokë)	cm.
			19	Gjatësia e supit	cm.
			20	Gjatësia nga supi në brryl	cm.
			21	Gjatësia e krahut, nga supi në kyçin e dorës.	cm.
			25	Gjatësia e personit	cm.

3. NGJYRAT REFERENCË

Ngjyra blu spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349 për tekstilin e xhupit, astarëve, zinxhirëve dhe elementëve *velcro*.

Ngjyra gri e argjendtë spektri sipas CIELCH 73, 0.743, 200.028, për stampën dhe elementët reflektivë.

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.



Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *xhup treçereksh*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 80 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.


Aplikimi i frazelinës

Ngjitja e frazelinës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën 130–140 °C, me kohëzgjatje 8–10 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagjes nga shiu. Nuk lejohet aplikimi i frazelinës me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

5. NDËRTIMI I XHUPIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të xhupit treçereksh

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.






Xhupat për femra dhe për meshkuj duhet të jenë identikë në tekstil dhe ngjyrë përveç modelimit që duhet të jetë sipas gjinisë.

Pjesët përbërëse të xhupit:

- Jaka
- Dy pjesët e përparme
- Dy pjesët e pasme
- Katër xhepa të përparmë
- Mëngët
- Kapakët e mëngëve
- Spaletat

JAKA



Jaka e xhupit duhet të jetë në formë rrethore, rreth 6 cm e lartë. Ajo duhet të përbëhet nga dy shtresa, pjesa e jashtme me tekstil të njëjtë (si xhupi) e përforcuar me frazelinë termoadezive dhe pjesa e brendshme me tekstil të dërstiluar.

Buzët e jakës duhet të përshkohen nga tre tegela linearë perimetralë një gjilpërësh sipërfaqësorë: një tegel në buzën e sipërme dhe dy tegela në buzën e poshtme.


PJESËT E PËRPARME

Mbyllja e xhupit duhet të bëhet me anë të zinxhirit. Zinxhiri duhet të jetë i mbuluar gjatë gjithë gjatësisë së tij me një bordurë me gjerësi rreth 5 cm për mbrojtjen nga era ndërsa në pjesën e sipërme duhet të mbulohet nga palosja e filetos së zinxhirit për të mbrojtur qafën nga gërvishtjet e zinxhirit. Fileto e zinxhirit duhet të jetë më e gjatë se zinxhiri në mënyrë që të realizohet palosja.

Bordura duhet të mbyllet me anë të 7 percinave metalike.

Buzët e bordurës (tek mbyllja) duhet të përshkohen nga një tegel linear vertikal sipërfaqësor një gjilpërësh.


XHEPAT E PËRPARMË



Xhupi duhet të pajiset me katër xhepa të jashtëm me kapak dhe fileto. Kapakët dhe filetot duhet të përbëhen nga dy shtresa me tekstil të njëjtë (si xhupi), të përforcuara me frazelinë termoadezive.

Buzët e lira të kapakëve, buzët anësore të filetove dhe tekstili sipër kapakut duhet të përshkohen nga tegela linearë perimetralë një gjilpërësh sipërfaqësorë. Mbyllja e xhepave duhet të bëhet me perçinë metalike.

Kapaku i xhepit



Filetoja e xhepit



Përmasat referencë për xhepat	A	B	C	D
Xhepat e vegjël të sipërm	12 cm	4.5 cm	12 cm	1.5 cm
Xhepat e mëdhenj të poshtëm	18 cm	5.5 cm	18 cm	2 cm

PJESËT E PASME

Mbrapa xhupi duhet të përbëhet nga dy pjesë të qepura me njëra-tjetrën me tegel linear një gjilpërësh, pjesa e shpatullave dhe pjesa e shpinës. Pjesa e shpatullave duhet të pajiset me një xhep të fshehtë, nga i cili duhet të dalë një copë drejtkëndore tekstili me fjalën POLICIA të stampuar në sipërfaqe. Xhepi duhet të mbyllet me anë të tre elementëve Velcro të fshehur.

E gjithë linja e bashkimit duhet të përshkohet nga një fileto cilindrike reflektive/dekorative dhe nga një tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor. Tegeli sipërfaqësor duhet të jetë në distancë 1 mm mbi buzën.


Kujdes! Përveç tegelit sipërfaqësor dhe filetos cilindrike, tek shpatullat nuk duhet të duket asnjë tegel apo element tjetër.

Në pjesën e belit, xhupi duhet të pajiset me llastik të brendshëm 5–6 cm të gjatë. Qepja e llastikut duhet të bëhet me anë të tegelit linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

BORDURA E POSHTME

Në fund xhupi duhet të mbyllet me një bordurë në formë tubolare me lartësi rreth 2 cm, brenda së cilës duhet të kalojë një kordon (llastik tubolar) që shërben për shtrëngimin e bordurës. Kordoni duhet të pajiset me mekanizma shtrëngues plastik në të dyja ekstremitetet.

SPALETAT



Spaletat duhet të jenë drejtkëndore në njërin anë dhe me kulm (me formë shigjete) në anën tjetër. Ana drejtkëndore duhet të qepet tek tegeli i rrethit të mëngës (gavatura). Katër brinjët e tjera përshkohen nga një tegel perimetral sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 5 mm nga buza.


Spaleta duhet të ndërtohet me dy shtresa tekstili ngjyrë blu (njësoj si xhupi) me përmasa të njëjta. Shtresa e sipërme e spaletës duhet të përforcohet me frazelinë termoadezive.

Perçina duhet të jetë në anën e “shigjetës”, distancë rreth 1.5 cm nga kulmi.

Perçina duhet të qepet në të njëjtin pozicion tek supi i xhupit. Perçina duhet të jetë me diametër 17 mm, metalike, ngjyrë të zezë.

Gjatësia e spaletës duhet të ndryshojë në varësi të masës së xhupit. Gjatësia e spaletës duhet të rritet me 2–3 mm për çdo masë. Përmasat bazë duhet të jenë këto: 13.5 x 4.8 cm për masën më të vogël të xhakëtës dhe 18 x 4.8 cm për masën më të madhe të xhupit.

MËNGËT



Mëngët duhet të ndërtohen me dy pjesë gjatësore, të cilat duhet të qepen me njëra-tjetrën me tegela lineare një gjilpërësh: një tegel gjatësor tek aksi vertikal i sqetullës dhe një tegel gjatësor tek aksi vertikal i bërrylit. Bashkë me tegelin e aksit të bërrylit duhet të qepet edhe filetoja cilindrike reflektive/dekorative.

Tegeli tek aksi i bërrylit duhet të lidhet me tegelin e pjesëve të pasme të xhupit, në mënyrë që të formohet një linjë e vetme dekorative.

Në distancë 1mm mbi tegelin qepës duhet qepur një tjetër tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Kapakët. Në fund mëngët duhet të mbyllen me kapakë në formë bordure me lartësi rreth 4 cm, të cilat duhet të përbëhen nga dy shtresa tekstili të njëjtë (si xhupi) të përforcuara nga brenda me frazelinë termoadezive.


Kapakët duhet të pajisen me gjuhëz me elementëve *Velcro* për të shtrënguar mëngën.

Buzët e lira të manshetave duhet të përshkohen nga një tegel perimetral linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

ASTARI

Xhupi duhet të vishet tek pjesa e trupit dhe mëngëve me astar me mbushje. Astar duhet të qepet tek paramontura.

Xhepat e brendshëm. Xhupi duhet të pajiset me dy xhepa të brendshëm me zinxhir 17 cm të gjatë. Një xhep në të majtë dhe një në të djathtë. Filetot e xhepave duhet të ndërtohen me tekstil të njëjtë si xhupi. Astar i xhepave të brendshëm duhet të jetë me përmasa 18 x 23 cm.



SHKRIMI POLICIA MBRAPA XHUPIT

Për xhupin e masës M



Fjala POLICIA duhet të stampohet në një copë drejtkëndore tekstili të njëjtë me xhupin të palosur më dysh me përmasa 42 x 15 cm. Copa e tekstilit duhet të qepet në brendësi të xhepit të shpatullave.

Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i gërmës.

Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i gërmës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampa duhet të jetë reflektive me ngjyrë gri. Stampa duhet të jetë e cilësisë së parë dhe të mos e humbasë efektin reflektiv gjatë përdorimit.

Kujdes! Përmasat e stampës mund të ndryshojnë (proporcionalisht) tek masat e vogla dhe tek masat e mëdha.


VELCRO


Xhupi duhet të pajiset me tre elementë *Velcro* femër:

- 1 copë për vendosjen e gradës së gjoksit/numrit të identifikimit me përmasa 8.6 x 3 cm.
- 1 copë për vendosjen e stemës së policisë në mëngën e majtë me përmasa 7 x 8 cm.
- 1 copë për vendosjen e shenjave në mëngën e djathtë me përmasa 7 x 8 cm.

Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel zig-zag perimetral me ngjyrë blu dhe të përforcohen me dy tegela diagonale. Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e shtresës përforcuese prej frazeline në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstilit gjatë qepjes dhe përdorimit.

Elementët *Velcro* në mëngë duhet të ketë një distancë rreth 6 cm nga gavatura e mëngës.





Kujdes! Elementët Velcro të mëngës së djathtë duhet të priten në përputhje me shërbimin që kryen punonjësi i policisë. Kufiri i lejuar i gabimit tek elementët Velcro është ± 1 mm.

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së xhupit duhet të jenë me hap 4 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
 - Tegelat qepës tek gavaturat e mëngëve, pjesa e supeve, para dhe pas duhet të jenë të termosaldura.
- Të gjithë elementët e xhupit duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili i xhupit nuk duhet të krijojë rrudha gjatë përdorimit.
- Xhupi duhet të jetë i lehtë për tu mirëmbajtur.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e xhupit është $\pm 2\%$. Tek qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.

- Vendosja e perçinave në xhup duhet të bëhet rreptësisht sipas përshkrimit tek *Specifikimet Teknike*.
- Perçinat duhet të kenë pamje të rregullt. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishten ose të pësojnë dëmtime të tjera.
- Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Artikulli *xhup treçereksh* duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, gjinia, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Tek xhepi i brendshëm i djathtë (i veshur) duhet të qepet një etiketë.

Perçina rezervë duhet të vendoset në një qese plastike polietileni ose prej kartoni të hollë, të mbyllur mirë. Perçina rezervë duhet të jetë e pranishme tek secili xhup. Ajo duhet të vendoset gjatë paketimit në etiketën e xhupit me një fije plastike të siguruar mirë.

Në momentin e dorëzimit xhupat duhet të jenë të pastër, të hekurosur dhe pa njolla. Xhupat e palosur duhet të futen në qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen xhupa të së njëjtës masë dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë një sasi të barabartë xhupash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e xhupit, gjinia, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.

	EN ISO 2286-2:2016 Tekstile të gomuara ose të plastifikuara - Pjesa 2: Metodatat për përcaktimin e masës së përgjithshme për njësi të sipërfaqes, masës për njësi të veshjes të sipërfaqes dhe masës për njësi të shtresave
Përshkueshmëria e ujit (presioni hidrostatik)	EN ISO 4920:2012 Pëlhura tekstili - Përcaktimi i qëndrueshmërisë në njomjen sipërfaqësore (prova me sprucim) EN ISO 6330:2012 Tekstile - procedurat e larjes dhe tharjes në kushte shtëpie për testimin e tekstileve EN 20811/ EN ISO 811:2018 Tekstile - përcaktimi i qëndrueshmërisë ndaj depërtimit të ujit - testi nën presionin hidrostatik
Aftësia ajërosëse e tekstilit	EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike nën ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga djersitja)
Rezistenca termike	EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike nën ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga djersitja)
Përshkueshmëria e ajrit	EN ISO 9237 :1995 Tekstilet - Përcaktimi i depërtueshmërisë së pëlhurave nga ajri
Qëndrueshmëria në tërheqje	EN ISO 1421:2016 Tekstile të gomuara ose të plastifikuara - Përcaktimi i forcës tërheqëse dhe zgjatimit në këputje
Qëndrueshmëria në grisje	EN ISO 4674-1 (A):2016 Tekstile të gomuara ose të plastifikuara -Përcaktimi i qëndrueshmërisë në grisje - Pjesa 1: Shkalla konstante e metodave të grisjes
Stabiliteti dimensional	EN ISO 3175: 2018 Tekstile - Kujdesi profesional, pastrimi i thatë dhe me lagështi i pëlhurave dhe veshjeve - Pjesa 1: Vlerësimi i performancës së provës pas pastrimit dhe procesit përfundimtar
	EN ISO 3759:2011 Tekstilet - Përgatitja, markimi dhe matja e kampioneve të pëlhurave dhe të veshjeve në provat për përcaktimin e ndryshimit të përmasave
	EN ISO 5077:2007 Tekstile - Përcaktimi i ndryshimit në larje dhe në tharje
	EN ISO 6330:2012 (6N) Tekstile - Procedurat e larjes dhe tharjes në kushte shtëpie për testimin e tekstileve
	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi.

Qëndrueshmëria e ngjyrës	(pas 5 cikle te larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj detersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Rezistenca ndaj hidrokarbureve (padepërtueshmëria ndaj vajërave)	EN ISO 14419:2010 Tekstilet- Padepërtueshmëria ndaj vajërave- Testi i rezistencës ndaj hidrokarbureve
Rezistenca ndaj delaminacionit (pas 30 cikle larjesh)	EN ISO 6330:2012 (A1, 4N) Tekstile - Procedurat e larjes dhe tharjes në kushte shtëpie për testimin e tekstileve
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Materialet reflektive	EN ISO 20471: 2013/ A1:2016 Standardi për shiritat reflektive dhe veshjet për sigurinë në punë.
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
Ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Kostumi dimëror për patrullat dhe motoçiklistët

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikujve të kostumit duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349			
Pesha	250–300 gr/m ²			
	Shtresa e jashtme	tekstil i endur		
	Thurja	Ripstop		
	Përbërja	100% poliestër		
	Shtresa e brendshme	Membranë		
	Përbërja	100% Polytetrafluoroethylene (PTFE)		
	Shtresa e trete	100% Poliestër		
Përshkueshmëria e ujit	mbi 20,000 mm			
	Fillestare	≥ ISO 5		
	pas 3 larjeve në 40°C	≥ ISO 3		
Përshkueshmëria e ujit (presioni hidrostatik)	mbi 50 mbar/min			
Aftësia ajërosëse e tekstilit	> 15,000 gr/m ² /24h	ajërosje shumë e mirë	Ret ≤ 7 m ² Pa/ W	
Rezistenca termike	≥ 0.030 m ² K/W			
Përshkueshmëria e ajrit	≤ 5 l/m ² /s			
Qëndrueshmëria në tërheqje	baza	≥ 750 N	indi	≥ 600 N
Qëndrueshmëria në grisje	baza	≥ 65 N	indi	≥ 65 N
Stabiliteti dimensional	± 3% në bazë dhe në ind			
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4 – 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.		
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.		
Rezistenca ndaj hidrokarbureve (padepërtueshmëria ndaj vajërave)	Fillestare ≥ 5 Pas 3 larjesh ≥ 4 (temp 40°C, tharje ne ajër)			
Rezistenca ndaj delaminacionit (pas 30 cikle larjesh)	Nuk ka delaminacion, vrima apo flluska më të mëdha se 3 mm			
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 50,000 cikle			

Efekti pilling (kokërzimi)	nota 5
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm
pH	4.0 - 9.0

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstileve të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron ofertën teknike të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: jo më pak se – nota 6: shumë e mirë.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në ofertën teknike do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra nuk njollos tekstilin e bardhë.


Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elementë Velcro që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

XHUPAT

b. Materialet ndihmëse dhe aksesoret që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit:
xhupi i kostumit:

Astarët	
Astar i lëvizshëm me mbushje me filtër për jakën, trupin dhe mëngët e xhupit 	Shtresa e jashtme
	Përbërja 100% poliestër
	Thurja diagonale
	Pesha 90 gr/m ²
	Ngjyra blu e errët
	Mbushja
	Përbërja 100% fibra poliestër
	Pesha 100 gr/m ²
	Shtresa e brendshme
	Përbërja 100% poliestër
	Thurja e trikotuar dhe e derstiluar

	Pesha	250 gr/m ²	
	Ngjyra	blu e errët	
Astar në formë rrjete për trupin dhe xhepat e pllakëzave mbrojtëse 	Përbërja	90% poliestër	10% <i>spandex</i>
	Pesha	90 gr/m ²	
	Ngjyra	blu e errët	
Astar për mëngët dhe xhepat. 	Përbërja	50% pambuk	50% poliestër
	Pesha	80 gr/m ²	
	Ngjyra	blu e errët	
	Thurja	diagonale	
Përforcues (frazelinë adesive)			
Frazelinë termo adesive, në ngjyrë të errët për jakën, kapakët e xhepave, kapakët e mëngëve, shiritin e poshtëm të xhupit dhe spaletat.			
Aksesorë të tjerë			
Element <i>Velcro</i> femër për gjoksin, mëngët dhe <i>Velcro</i> femër/mashkull për kapakët e mëngëve. 	Përmasat <i>Velcro</i> femër të gjoksit		8.6 x 3 cm
	Përmasat <i>Velcro</i> femër të mëngëve		7 x 8 cm
	Përmasat <i>Velcro</i> femër/mashkull për gjuhëzën		2 x 10 cm
	Përbërja		100% fibra poliamide
	Trashësia		2.2 mm
	Masa lineare		41 g/m ± 5%
	Ngjyra		njësoj si tekstili
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
	E ftohtë		- 30° C
	E nxehtë	pika e dobësimit	180° C
pika e shkrirjes		210—250° C	
Qëndrueshmëria e ngjyrës			
Në larje		jo më pak se 3	
Në ujë të nxehtë			
Në djersë			
Në fërkim			
Llastik i gjerë për pjesën e poshtme të xhupit 	Përbërja		100% poliestër
	Ngjyra		e zezë
	Gjerësia		5 cm

Shirit për termosaldimin e disa qepjeve të xhupit. 	Me 3 shtresa	Poliamid PTFE shtresë termoadezive
	Ngjyra	e zezë
	Gjerësia	2 cm
	Trashësia	0.35 mm
	Me ajërosje të mirë dhe rezistencë të lartë ndaj ujit.	

Filli

Fill qepës për qepjet primare dhe të dukshme.	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	50 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12 N
	Ngjyra	njësoj si xhupi
Fill qepës për qepjet dytësore (astari i xhepave, astarët e xhupit etj.).	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	75 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12 N
	Ngjyra	njësoj si xhupi

Perçinat

	7 copë Nr. 27 (d 17 mm) + 1 rezervë	
	Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri)
	Ngjyra e perçinës	e zezë pa shkëlqim
	Kujdes! Perçina duhet të jetë e përshtatshme për tekstin e produktit ku do të montohet.	

Zinxhirat

Zinxhir për mbylljen e xhupit. 	Standard, me fund të hapur, me rezistencë maksimale ndaj ujit.	
	Madhësia e dhëmbëve	8 VF
	Shirit prej tekstili	poliester i veshur me poliueratn
	Dhëmbët	100% poliamid
Zinxhir për montimin dhe çmontimin e mëngëve të xhupit. 	Ngjyra	blu e errët
	Standard, me fund të hapur, për aplikime në linja të harkuara dhe me rezistencë maksimale ndaj ujit.	
	Madhësia e dhëmbëzave	8 VF
	Shirit prej tekstili	poliester i veshur me poliuretan
	Dhëmbët	100% poliamid
	Ngjyra	blu e errët

Zinxhir me fund të hapur, për montimin dhe çmontimin e astarit me mbushje. 	<table border="1"> <tr> <td colspan="2">Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur,</td></tr> <tr> <td>Montimi në xhup</td><td>Në anën e djathtë të veshur</td></tr> <tr> <td>Madhësia e dhëmbëve</td><td>4 CF ose 5 CF</td></tr> <tr> <td>Shirit prej tekstili</td><td>100% poliestër</td></tr> <tr> <td>Dhëmbët</td><td>monofilament 100% poliestër</td></tr> <tr> <td>Ngjyra</td><td>blu e errët</td></tr> </table>	Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur,		Montimi në xhup	Në anën e djathtë të veshur	Madhësia e dhëmbëve	4 CF ose 5 CF	Shirit prej tekstili	100% poliestër	Dhëmbët	monofilament 100% poliestër	Ngjyra	blu e errët		
Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur,															
Montimi në xhup	Në anën e djathtë të veshur														
Madhësia e dhëmbëve	4 CF ose 5 CF														
Shirit prej tekstili	100% poliestër														
Dhëmbët	monofilament 100% poliestër														
Ngjyra	blu e errët														
Zinxhir me fund të hapur, për montimin-çmontimin dhe mbylljen e astarit me mbushje.  	<table border="1"> <tr> <td colspan="2">Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur, dhe me kokë të rrotullueshme.</td></tr> <tr> <td>Montimi në xhup</td><td>Në anën e majtë të veshur</td></tr> <tr> <td>Madhësia e dhëmbëve</td><td>4 CF ose 5 CF</td></tr> <tr> <td>Shiriti prej tekstili</td><td>100% poliestër</td></tr> <tr> <td>Dhëmbët</td><td>100% poliestër monofilament</td></tr> <tr> <td>Ngjyra</td><td>blu e errët</td></tr> </table>	Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur, dhe me kokë të rrotullueshme.		Montimi në xhup	Në anën e majtë të veshur	Madhësia e dhëmbëve	4 CF ose 5 CF	Shiriti prej tekstili	100% poliestër	Dhëmbët	100% poliestër monofilament	Ngjyra	blu e errët		
Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur, dhe me kokë të rrotullueshme.															
Montimi në xhup	Në anën e majtë të veshur														
Madhësia e dhëmbëve	4 CF ose 5 CF														
Shiriti prej tekstili	100% poliestër														
Dhëmbët	100% poliestër monofilament														
Ngjyra	blu e errët														
Zinxhir për xhepat e brendshëm të xhupit. 	<table border="1"> <tr> <td colspan="2">Standard, me fund të mbyllur</td></tr> <tr> <td>Madhësia e dhëmbëzave</td><td>4 CF ose 5 CF</td></tr> <tr> <td>Shirit prej tekstili</td><td>100% poliestër</td></tr> <tr> <td>Dhëmbët</td><td>100% poliestër monofilament</td></tr> <tr> <td>Ngjyra</td><td>blu e errët</td></tr> </table>	Standard, me fund të mbyllur		Madhësia e dhëmbëzave	4 CF ose 5 CF	Shirit prej tekstili	100% poliestër	Dhëmbët	100% poliestër monofilament	Ngjyra	blu e errët				
Standard, me fund të mbyllur															
Madhësia e dhëmbëzave	4 CF ose 5 CF														
Shirit prej tekstili	100% poliestër														
Dhëmbët	100% poliestër monofilament														
Ngjyra	blu e errët														
Etiketa															
Etiketë prej tekstili për identifikimin e fabrikës, masës, gjinisë, mirëmbajtjes dhe përbërjes.	<table border="1"> <tr> <td>Përbërja</td><td>100% poliestër</td></tr> <tr> <td>Ngjyra</td><td>e bardhë</td></tr> </table>	Përbërja	100% poliestër	Ngjyra	e bardhë										
Përbërja	100% poliestër														
Ngjyra	e bardhë														
Stampa															
Shkrimi POLICIA, para, në xhup 	<table border="1"> <tr> <td colspan="2">Stampim me material/bojë reflektive</td></tr> <tr> <td>Ngjyra</td><td>gri, argjend</td></tr> <tr> <td>Përmasat referencë</td><td>1.7 x 8.6 cm</td></tr> <tr> <td>Lloji i germës</td><td>Myriad Pro Bold</td></tr> <tr> <td colspan="2">Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit ISO 20471:2013</td></tr> <tr> <td colspan="2">Me kënd të gjerë reflektimi</td></tr> <tr> <td colspan="2">Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjesh.</td></tr> </table>	Stampim me material/bojë reflektive		Ngjyra	gri, argjend	Përmasat referencë	1.7 x 8.6 cm	Lloji i germës	Myriad Pro Bold	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit ISO 20471:2013		Me kënd të gjerë reflektimi		Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjesh.	
Stampim me material/bojë reflektive															
Ngjyra	gri, argjend														
Përmasat referencë	1.7 x 8.6 cm														
Lloji i germës	Myriad Pro Bold														
Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit ISO 20471:2013															
Me kënd të gjerë reflektimi															
Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjesh.															
Shkrimi POLICIA, mbrapa, në xhup 	<table border="1"> <tr> <td colspan="2">Stampim me material/bojë reflektive</td></tr> <tr> <td>Ngjyra</td><td>gri, argjend</td></tr> <tr> <td>Përmasat referencë</td><td>7 x 35 cm</td></tr> <tr> <td>Lloji i germës</td><td>Myriad Pro Bold</td></tr> <tr> <td colspan="2">Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit ISO 20471:2013</td></tr> <tr> <td colspan="2">Me kënd të gjerë reflektimi</td></tr> </table>	Stampim me material/bojë reflektive		Ngjyra	gri, argjend	Përmasat referencë	7 x 35 cm	Lloji i germës	Myriad Pro Bold	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit ISO 20471:2013		Me kënd të gjerë reflektimi			
Stampim me material/bojë reflektive															
Ngjyra	gri, argjend														
Përmasat referencë	7 x 35 cm														
Lloji i germës	Myriad Pro Bold														
Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit ISO 20471:2013															
Me kënd të gjerë reflektimi															

Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjesh.
--

POLICIA E SHETIT

Stampat reflektive për pjesën e gjoksit dhe mëngëve të xhupit <i>Stampë reflektive</i>  <i>Hapsira pa stampë</i>	Stampim me material/bojë reflektive		
	Ngjyra	gri argjend	
	Përmasat	lartësia	3 cm
	Me kënd të gjerë reflektimi.		
	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit ISO 20471:2013		
	Stampa duhet të duket nga një distancë prej mbi 150 m		
	Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjesh.		

PANTALLONAT

c. Materialet ndihmëse dhe aksesoret që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit të pantallonave janë:

Astarët			
Astar me mbushje me filtër për pantallonat. 	Shtresa e jashtme		
	Përbërja	100% poliester	
	Thurja	Diagonale	
	Pesha	90 gr/m ²	
	Ngjyra	blu e errët	
	Mbushja		
	Përbërja	100% fibra poliester	
	Pesha	100 gr/m ²	
	Shtresa e brendshme		
	Përbërja	100% poliester	
Thurja	e trikotuar dhe e dërstiluar		
Pesha	250 gr/m ²		
Ngjyra	blu e errët		
Astar në formë rrjete për pantallonat dhe xhepat e pllakëzave mbrojtëse. 	Përbërja	90% poliester	10% <i>spandex</i>
	Pesha	90 gr/m ²	
	Ngjyra	blu e errët	
	Përbërja	50% pambuk	50% poliester
	Pesha	80 gr/m ²	
Astar për xhepat.	Ngjyra	blu e errët	
	Thurja	Diagonale	

Aksesorë të tjerë

Frazelinë termo adesive me ngjyrë të errët për qemerin, ylykët dhe kapakët e xhepave.

Element *Velcro* femër / mashkull për mbylljen e xhepave dhe shtrëngimin e gjuhëzës.



Përmasat Velcro femër/mashkull		2 x 2.5 cm
Përmasat Velcro femër/mashkull për gjuhëzën		3 x 13 cm
Përbërja	100% fibra poliamide	
Trashësia	2.2 mm	
Masa lineare	41 g/m ± 5%	
Ngjyra	njësoj si tekstili	
Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
E ftohtë	- 30° C	
E nxehtë	pika e dobësimit	180° C
	pika e shkrirjes	210 – 250° C
Qëndrueshmëria e ngjyrës		
Në larje	jo më pak se 3	
Në ujë të nxehtë		
Në djersë		
Në fërkim		

Llastik i gjerë për pjesën e qemerit të pantallonave.



Përbërja	100 % poliester
Ngjyra	e zezë
Gjerësia	5 cm

Llastik i ngushtë për pjesën e këmbëve të astarit me mbushje të pantallonave.

Përbërja	100 % poliester
Ngjyra	e zezë
Gjerësia	1 cm

Shirit për termosaldimin e qepjeve të pantallonave
Shirit për termosaldimin e qepjeve



Me 3 shtresa	Poliamid
	PTFE
	shtresë termoadezive
Ngjyra	e zezë
Gjerësia	2 cm
Trashësia	0.35 mm
Me ajërosje të mirë dhe rezistencë të lartë ndaj ujit	

Filli

Fill qepës për qepjet primare dhe të dukshme.

Përbërja	100% poliester
Numri metrik	50 Nm
Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12 N
Ngjyra	njësoj si tekstili

Fill qepës për qepjet dytësore (astari i

Përbërja	100% poliester
----------	----------------

xhepave, astarët e xhupit etj).	Numri metrik	75 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12 N
	Ngjyra	njësoj si tekstili
Kopsa		
Kopsa 	2 copë Nr. 27 (d 17 mm) + 1 rezervë	
	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	blu e errët
Zinxhirat		
Zinxhiri i pantallonave 	Standard, me fund të mbyllur.	
	Madhësia e dhëmbëzave	4 VF
	Shirit prej tekstili	100% poliestër
	Dhëmbët	100% poliestër
	Ngjyra	blu e errët
Zinxhir me fund të hapur, për montimin dhe çmontimin e astarit me mbushje. 	Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur, për aplikime në linja të harkuara.	
	Madhësia e dhëmbëzave	4 CF ose 5 CF
	Shirit prej tekstili	100% poliestër
	Dhëmbët	100% poliestër monofilament
	Ngjyra	blu e errët
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për identifikimin e fabrikës, masës, gjinisë, mirëmbajtjes dhe përbërjes.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë

d. Pllakat mbrojtëse për xhupin dhe pantallonat e kostumit për motoçiklistë janë:

Pllakat mbrojtëse për xhupat			
		Përbërja	shkumë "memory" prej poliuretani
		Pesha (mesatare)	për shpinën 270 gr / copë
			Shpatullat 160 gr / copë
			Brrylat 175 gr / copë
		Përmasat	në 2 masa kryesore, unisex (M - XL)
		Testime për rezistencën e gryerjes gjatë përplasjes. (Impact Abrasion Resistance Test Requirements)	EN-13595-2 Nivelin 2
		Testime për forcën shpërthyesë (Burst Strength Test Requirements)	EN-13595-3 - Nivelin 2
për shpinën	1 copë	Testime për rezistencën ndaj prerjeve gjatë përplasjes	EN-13595-4 - Nivelin 2
për shpatullat	2 copë		

për brrylat		2 copë	(Impact Cut Resistance Test Requirements)	
Pllakat mbrojtëse për pantallonat				
për gjunjë  për pjesën e legenit 	Përbërja	shkumë “memory” prej poliuretani		
	Pesha (mesatare)	për gjunjë	180 gr / copë	
		për pjesën e legenit	175 gr / copë	
	Përmasat	në 2 masa kryesore, unisex (M - XL)		
			Testime për rezistencën e gërhyes gjatë përplasjes. (Impact Abrasion Resistance Test Requirements)	EN-13595-2 Nivelin 2
		Testime për forcën shpërthyesë (Burst Strength Test Requirements)	EN-13595-3 - Nivelin 2	
për gjunjë	2 copë	Testime për rezistencën ndaj prerjeve gjatë përplasjes (Impact Cut Resistance Test Requirements)	EN-13595-4 - Nivelin 2	
për pjesën e legenit	2 copë			

e. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikujve të kostumit të patrullave dhe të motoçiklistëve.

1 qese polietileni për 1 xhup + 1 qese polietileni për 1 palë pantallona
1 qese polietileni për perçinën rezervë
1 qese polietileni për paketimin e kostumit
1 kuti kartoni për paketimin e kostumit

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT


Artikujt e kostumit dimëror për patrulla dhe motoçiklistë do të porositen dhe do të prodhohen në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Xhupat dhe pantallonat për femra duhet të prodhohen në masat 36 – 54.

Xhupat dhe pantallonat për meshkuj duhet të prodhohen në masat 44 – 66.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



Meshkuj			Femra		
2	Perimetri i qafës	cm.	1	Perimetri i kokës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.	2	Perimetri i qafës	cm.
4	Perimetri i belit	cm.	3	Perimetri i gjoksit	cm.
5	Perimetri në pjesën e barkut	cm.	4	Perimetri i krahavorit (poshtë gjoksit)	cm.
6	Perimetri i muskulit të krahut	cm.	5	Perimetri i belit	cm.
7	Perimetri i kyçit të dorës	cm.	6	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
8	Perimetri i gjurit poshtë kupës së tij	cm.	7	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
9	Perimetri i kyçit të këmbës (kaviljes)	cm.	8	Lartësia nga supi në gjoks	cm.
10	Gjatësia e plotë	cm.	9	Distanca mes gjokseve	cm.
11	Lartësi e përgjithshme e trupit mbrapa (nga supi në tokë)	cm.	10	Perimetri i krahut	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale deri tek linja e belit)	cm.	11	Perimetri i kyçit të dorës	cm.
13	Gjatësia e mes shpatullave	cm.	12	Lartësia përpara nga supi tek linja e belit	cm.
14	Gjatësia nga supi tek bërryli	cm.	13	Lartësia nga vija e belit tek linja e kockës abdominale	cm.
15	Gjatësia e krahut, nga supi tek kyçi i dorës	cm.	14	Lartësia e pjesës abdominale (nga linja e belit tek linja e vitheve)	cm.
16	Lartësia e pjesës nga vija e supit tek linja e belit	cm.	15	Gjatësia nga beli tek linja e gjurit (poshtë kupës së gjurit)	cm.
17	Gjatësia nga beli tek linja e gjurit (poshtë kupës së gjurit)	cm.	16	Gjatësia nga beli tek kocka e kaviljes	cm.
18	Gjatësia nga beli tek kyçi i këmbës	cm.	17	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale tek linja e belit)	cm.
19	Gjatësia e brendshme e këmbës deri tek vija e gjurit	cm.	18	Lartësia e përgjithshme e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në tokë)	cm.
20	Gjatësia e brendshme e këmbës deri	cm.	19	Gjatësia e supit	cm.

	tek kyçi i këmbës				
21	Gjatësia e shtratit e matur në pozicion ulur	cm.	20	Gjatësia nga supi në bërryl	cm.
			21	Gjatësia e krahut, nga supi tek kyçi i dorës	cm.
			22	Gjatësia e shtratit e matur ulur	cm.
			23	Gjatësia e brendshme këmbës deri në vijën e gjurit.	cm.
			24	Gjatësia e brendshme këmbës deri në kavalje	cm.
			25	Gjatësia e personit	cm.

3. NGJYRAT REFERENCË

Ngjyra blu spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349 për tekstilin e xhupit, pantallonave, astareve dhe Velcro-ve.
Ngjyra gri spektri sipas CIELCH 73, 0.743, 200.028 për stampën reflektive (fluoreshent).



Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecure cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikujve të kostumit dimëror për patrulla dhe motoçiklistë.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 80 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Aplikimi i frazelinës

Ngjitja e frazelinës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën 130–140 °C, me kohëzgjatje 8–10 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet aplikimi i frazelinës me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

5. NDËRTIMI I KOSTUMIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të kostumit për patrulla dhe motoçiklistë

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



I. XHUPAT




Xhup i shkurtër 3 në 1

- * me astar të hollë për kohë të ngrohtë
- * me astar të mbushur, të çmontueshëm
- * me mëngë të çmontueshme për tu kthyer në jelek



Xhup për motoçiklistët

- * me astar të hollë për kohë të ngrohtë
- * me astar të mbushur dhe të çmontueshëm për kohë të ftohtë
- * me mëngë të çmontueshme për tu kthyer në jelek
- * me mbrojtëse në shpatulla, shpinë dhe brryla (të ilustruara me të verdhë)




Xhupat për femra dhe për meshkuj duhet të jenë identikë në tekstil dhe ngjyrë përveç modelimit që duhet të jetë sipas gjinisë.

Pjesët përbërëse të xhupit:

- Jaka
 - Dy pjesët e përparme
 - Pjesa e pasme
 - Bordura e poshtme
 - Dy xhepa të përparmë
 - Mëngët
 - Kapakët e mëngëve
 - Spaletat
 - Astartet
 - Elementët reflektivë
 - Xhepat për vendosjen e pllakave mbrojtësve të shpinës, shpatullave dhe brrylave.
- Vetëm për kostumin e motoçiklistëve.*

JAKA



Jaka e xhupit duhet të jetë në formë rrethore, rreth 6 cm e lartë. Ajo duhet të përbëhet nga dy shtresa me tekstil të njëjtë (si xhupi), e përforcuar me frazelinë termoadezive.


Buzët e jakës duhet të përshkohen nga tre tegela lineare perimetrale një gjilpërësh sipërfaqësorë një tegel në buzën e sipërme dhe dy tegela në buzën e poshtme.

PJESËT E PËRPARME

Ana e përparme e xhupit duhet të ndërtohet në dy pjesë.

Mbyllja e xhupit duhet të bëhet me anë të zinxhirit. Zinxhiri duhet të jetë i mbuluar me bordurë me gjerësi rreth 5 cm, për tu mbrojtur nga era. Bordura duhet të mbyllet me anë të 5 perçinave metalike. Buzët e bordurës (tek mbyllja) duhet të përshkohen nga një tegel linear vertikal sipërfaqësor një gjilpërësh.

XHEPAT E PËRPARMË



Xhupi duhet të pajiset me dy xhepa të jashtëm me fileto dhe zinxhir. Filetoja e xhepit duhet të përbëhet nga dy shtresa me tekstil të njëjtë (si xhupi), e përforcuar me frazelinë termoadezive.

Buza e sipërme dhe pjesët anësore të filetove të xhepave duhet të përshkohen nga tegela lineare perimetrale një gjilpërësh sipërfaqësorë.

Mbyllja e xhepave duhet të bëhet me zinxhir. Hapja e xhepit duhet të jetë 18 cm e gjërë.

Kujdes! Përmasat e xhepave mund të ndryshojnë tek masat e vogla ose të mëdha të xhupit por pa prishur raportet e specifikuar tek ilustrimi teknik.


PJESA E PASME

Mbrapa xhupi duhet të përbëhet nga një pjesë e vetme.

BORDURA E POSHTME

Në pjesën e poshtme xhupi duhet të përfundojë me një bordurë rreth 5 cm të lartë. Bordura duhet të përbëhet nga dy shtresa tekstili të njëjtë (si xhupi) të përforcuara nga brenda me frazelinë termoadezive. Tek dy pjesët anësore (në të majtë dhe në të djathtë), bordura duhet të jetë e pajisur me iletik.

SPALETAT



Spaletat duhet të jenë drejtkëndore në njërin anë dhe me kulm (me formë shigjete) në anën tjetër. Ana drejtkëndore duhet të qepet tek tegeli i rrethit të mëngës (gavatura). Katër brinjët e tjera përshkohen nga një tegel perimetral sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 5 mm nga buza.

Spaleta duhet të ndërtohet me dy shtresa tekstili ngjyrë blu (njësoj si xhupi) me përmasa të njëjta. Shtresa e sipërme e spaletës duhet të përforcohet me frazelinë termoadezive.

Perçina duhet të jetë në anën e "shigjetës", distancë rreth 1.5 cm nga kulmi.

Perçina duhet të qepet në të njëjtën pozicion tek supi i xhupit. Perçina duhet të jetë me diametër 17 mm, metalike, ngjyrë të zezë.

Gjatësia e spaletës duhet të ndryshojë në varësi të masës së xhupit. Gjatësia e spaletës duhet të rritet me 2–3 mm për çdo masë. Përmasat bazë duhet të jenë këto: 13.5 x 4.8 cm për masën më të vogël të xhakëtës dhe 18 x 4.8 cm për masën më të madhe të xhupit

MËNGËT

Mëngët duhet të jenë të lëvizshme. Ato duhet të hiqen dhe të vihen sipas dëshirës me anë të zinxhirit të përshtatshëm për linja të harkuara. Zinxhiri duhet të qepet në gjithë perimetrin e gavaturës së mëngës dhe fillimi dhe fundi i zinxhirit duhet të jenë të puthitur. Zinxhiri duhet të jetë i cilësisë së lartë, të mos hapet vetë gjatë përdorimit dhe të mbyllet mirë deri në fund.

Mëngët duhet të ndërtohen me një pjesë e vetme tekstili ngjyrë blu të errët.

Kapakët. Në fund mëngët duhet të mbyllen me kapakë në formë bordure me lartësi rreth 4 cm, të cilat duhet të përbëhen nga dy shtresa tekstili të njëjtë (si xhupi) të përforcuara nga brenda me frazelinë termoadezive.

Kapakët duhet të pajisen me gjuhëzës me elementë *Velcro* për të shtrënguar mëngën.



Buzët e lira të manshetave duhet të përshkohen nga një tegel perimetral linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

ASTARI

Xhupi duhet të vishet tek pjesa e trupit me astar në formë rrjete, ndërsa tek mëngët me astar prej tekstili. Astar i mëngëve duhet të jetë i veçuar nga astari i trupit, pasi mëngët duhet të jenë të lëvizshme. Astar i trupit duhet të qepet tek paramontura dhe gavaturat. Ndërsa astari i mëngëve duhet të qepet tek gavaturat dhe fundet e mëngëve.

ASTARI I LËVIZSHËM


Astar i brendshëm i lëvizshëm



Me astar të mbushur, për kohë të ftohtë



Me astar prej rrjete, për kohë të ngrohtë



Xhupi (me gjithë mëngët) duhet të pajiset me astar tjetër të lëvizshëm me mbushje që mund të montohet tek xhupi.

Astar i lëvizshëm duhet të shërbejë edhe si xhup i lehtë pranveror. Ai duhet të montohet në xhup me anë të zinxhirit të astarit të lëvizshëm dhe zinxhirëve të montuar në brendinë e xhupit.

Zinxhiri i astarit të lëvizshëm duhet të shkojë deri në fund të jakës. Koka e zinxhirit të astarit të lëvizshëm duhet të jetë e rrotullueshme, me përdorim të dyanshëm.

Astari i lëvizshëm duhet të përbëhet nga tre shtresa: shtresa e jashtme prej tekstili methurje diagonale, mbushja me fibra poliestre dhe shtresa e brendshme (në kontakt me trupin) prej tekstili të trikotuar dhe dërstiluar.


Përveç qepjes perimetrale, shtresat duhet të qepen me njëra tjetrën edhe me anë të tegelave lineare një gjilpërësh që krijojnë motive me rombe në të gjithë sipërfaqen. Përmasat e rombeve duhet të jenë përafërsisht 5 x 5 cm.

Jaka e astarit duhet të jetë në formë rrethore, rreth 4 cm e lartë.

XHEPAT E BRENDSHËM.

Xhupi duhet të pajiset me dy xhepa të brendshëm me zinxhir 17 cm të gjatë, një xhep në të majtë dhe një në të djathtë. Filetot e xhepave duhet të jenë me tekstil të njëjtë si xhupi. Xhepat e brendshëm duhet të qepen tek astari prej rrjete.

Astari i xhepave të brendshëm duhet të jetë i njëjtë me astarin e mëngëve. Përmasat e astarit duhet të jenë 18 x 23 cm.



STAMPA REFLEKTIVE

Xhupat duhet të pajisen me stampë reflektive fluoeshente, lehtësisht të dallueshme. Stampa duhet të jetë 3 cm e lartë, me vija horizontale. Stampa duhet të stampohet përgjatë gjithë perimetrit të gjoksit dhe të krahëve.

Stampa reflektive duhet të jetë e cilësisë më të lartë. Ajo nuk duhet të fshihet apo të humbasë efektin reflektiv gjatë përdorimit, nuk duhet të pësojë plasaritje apo dëmtime të tjera. Stampa duhet të stampohet drejt dhe të mos ketë pjesë të pa ngjitura mirë ose valëzime në të gjithë gjatësinë e saj.

Stampë reflektive



XHEPAT E PLLAKAVE MBROJTËSE PËR KOSTUMET E MOTOÇIKLISTËVE

Vetëm xhupat e motoçiklistëve, duhet të pajisen me xhepa të brendshëm për vendosjen e pllakave mbrojtëse. Xhepat duhet të jenë prej rrjete dhe të kenë formën e pllakave dhe të qepen tek shpatullat, brrylat dhe në shpinë.

SHKRIMI “POLICIA”, PËRPARA



Në pjesën e përparme të xhupit, në anën e djathtë të gjoksit, duhet të stampohet fjala POLICIA. Stampa duhet të pozicionohet 1 cm mbi elementin Velcro në të djathtë.

Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Germat duhet të stampohen me precizion të lartë. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i germës. Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i germës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampimi duhet të jetë prej materiali reflektiv fluoreshent ngjyrë gri, si shiriti i vijëzuar. Përmasat e shkrimit të vogël duhet të jenë për të dyja gjinitë njësoj, 8.6 x 1.7 cm.

SHKRIMI “POLICIA”, MBRAPA

Stampë reflektive (fluorescent)



Në pjesën e pasme të xhupit, në shpinë, duhet të stampohet shkrimi POLICIA. Shkrimi duhet të jetë i vendosur në qendër të shpinës (sipas ilustrimit teknik).

Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik me përmasa 35 x 7 cm. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i germës.

Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i germës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampa duhet të jetë reflektive me ngjyrë gri. Stampa duhet të jetë e cilësisë së parë dhe të mos e humbasë efektin reflektiv gjatë përdorimit.

Kujdes! Përmasat e stampës mund të ndryshojnë (proporcionalisht) tek masat e vogla dhe tek masat e mëdha.

ELEMENTËT VELCRO

Xhupi duhet të pajiset me 3 elementë *Velcro* femër:

- 1 copë për vendosjen e gradës së gjoksit/ numrin e identifikimit me përmasa 8.6 x 3 cm.
- 1 copë me përmasa 8 x 7 cm me formën e stemës së policisë në mëngën e majtë.
- 1 copë me përmasa 8 x 7 cm për vendosjen e shenjave në mëngën e djathtë.


Elementi *Velcro* për vendosjen e shenjave në mëngë duhet të ketë një distancë rreth 4 cm nga gavatura e mëngës.

Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel linear perimetral me ngjyrë blu dhe të përforcohen me dy tegela diagonale. Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e shtresës përforcuese prej frazeline në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstilit gjatë qepjes dhe gjatë përdorimit.


Kujdes!! Elementët *Velcro* të mëngës së djathtë duhet të priten në përputhje me shërbimet që kryen punonjësi i policisë. Përmasat e *Velcro* kanë tolerancë ± 1 mm.



Në pjesën e djathtë




Velcro femër, për stemën e
policisë në krahun e majtë.
Përmasat 8 x 7 cm




Velcro femër për shenjat e
shërbimit në krahun e djathtë.
Përmasat 8 x 7 cm

II. PANTALLONAT

Per femra





Per meshkuj




Mbrapa



Pantallona për patrullat



Pantallona për motoçiklistët



Pantallonat duhet të ketë të njëjtin model, tekstil dhe ngjyrë për të dyja gjinitë.

Pjesët përbërëse të pantallonave:

- Qemeri
- Katër pjesët e këmbëve
- Dy xhepat e përparmë
- Dy xhepat e këmbëve
- Dy xhepat e pasmë
- Dy arnat për gjunjë
- Arna në pjesën e vitheve
- Astarët e pantallonave
- Xhepat për vendosjen e pllakave mbrojtëse të gjunjëve dhe ijeve, vetëm në pantallonat e motoçiklistëve.

QEMERI

Lartësia e qemerit duhet të jetë 5 cm. Ai duhet të jetë i përbërë nga një shtresë tekstili e palosur më dysh, e përforcuar nga brenda me frazelinë termoadezive. Tek dy pjesët anësore (në të majtë dhe në të djathtë), qemeri duhet të jetë i pajisur me llastik.

Në anën e djathtë të veshur të qemerit duhet të hapet një vrimë me gjatësi 25 mm për kopsën, ndërsa në tjetrën duhet të qepet kopsa e pantallonave.

Qemeri duhet të përshkohet nga një tegel linear perimetral një gjilpërësh sipërfaqësorë me distancë 2 mm nga buzët. Tegeli i poshtëm duhet të bëjë edhe bashkimin e qemerit me pantallonat.

Llastikët e veshur me tekstin e qemerit duhet të përshkohen edhe nga dy tegela të tjerë linearë një gjilpërësh sipërfaqësorë paralel dhe të baraslarguar nga tegeli perimetral. Llastikët duhet të kufizohen tek ekstremitetet me pjesën e tjetër të qemerit me nga një tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor vertikal.

Poshtë qemerit duhet qepur një fileto me zinxhir për astarin e lëvizshëm me mbushje.

Kopsat duhet të jenë Nr. 34 (21 mm) me ngjyrë blu të errët. Qepja e kopsave duhet të bëhet kryq. Një kopsë rezervë duhet të qepet në pjesën e brendshme të qemerit, në anën e majtë.

Ylyqet. Pantallonat duhet të kenë 6 ylyqe me gjatësi 6.5 cm dhe gjerësi 2.5 cm: dy përpara dhe katër mbrapa. Ylyqet e përparme duhet të vendosen të baraslarguar nga xhepat anësorë në një distancë prej 2–3 cm, sipas masës. Ylyqet e pasme gjithashtu duhet të vendosen të baraslarguara nga njëra tjetra, sipas masës.

Ylykët duhet të përbëhen nga një shtresë tekstili ngjyrë blu (si pantallonat) e palosur më dysh, të përforcuar nga brenda me frazelinë.

Ylykët duhet të përshkohen nga dy tegela dy gjilpërësh gjatësorë me distancë 6 mm nga njëri tjetri dhe dy tegela linearë një gjilpërësh me distancë 2 mm nga buza e poshtme dhe e sipërme. Tegelat gjatësorë duhet të përforcohen me travesta tek ekstremitetet. Tegelat duhet të jenë të gjithë sipërfaqësorë.

KËMBËT


Këmbët e pantallonave duhet të ndërtohen me katër pjesë: dy pjesët e përparme dhe dy pjesët e pasme.

Bashkimi i këmbëve të pantallonave duhet të bëhen me anë të një tegeli linear një gjilpërësh të profiluar me tegela syzator tre gjilpërësh dhe një tegel linear.

Bashkimi anësor i jashtëm, i brendshëm dhe bashkimi qendror duhet të përshkohen dhe me anë të një tegeli linear dy gjilpërësh sipërfaqësor.

Këmbët duhet përfundojnë me një palosje të brendshme 2 cm të qepur me tegel linear një gjilpërësh me distancë 2 cm nga buza.

Gjuhëza për shtrëngimin e këmbëve. Këmbët e pantallonave duhet të pajisen në fund, në anën e pasme, me një gjuhëz për efekt shtrëngues. Gjuhëza duhet të qepet midis dy pjesëve anësore të tekstit të pantallonave. Ajo duhet të shtrëngohet me anë të elementëve *Velcro*.



Sallkia duhet të ndërtohet me dy pjesë: pjesa e mbuluar dhe kapaku i zinxhirit. Të dyja pjesët duhet të jenë prej tekstili të njëjtë si pantallonat.

Shtresa e dukshme e pjesës së mbuluar dhe shtresa e padukshme e kapakut duhet të jenë të përforcuara me frazelinë termoadezive.

Zinxhiri i sallkisë. Gjatësia e zinxhirit mund të ndryshojë sipas masave, nga 16–18 cm. Zinxhiri duhet të jetë me fiksime tek koka në mënyrë që të mos hapet vetë gjatë përdorimit. Ngjyra e zinxhirit duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e pantallonave.

Arnat përforcuese të gjunjëve duhet të jenë prej të njëjtit tekstil si pantallonat. Ato duhet të kenë formë trapezi dhe përmasat e tyre duhet të ndryshojnë në varësi të masës së pantallonave.

Buza e sipërme dhe e poshtme e arnës duhet të jenë të qepura me tegela lineare dy gjilpërësh sipërfaqësore me distancë 2 dhe 8 mm nga buza. Buzët anësore të arnës duhet të qepen në tegelat qepës anësore të pantallonave.

Arnat përforcuese të vitheve duhet të qepen në zonën e poshtme të vitheve. Ato duhet të jenë prej të njëjtit tekstil si pantallonat.

Arnat duhet të kenë formë gjysmë elipsi dhe përmasat e tyre duhet të ndryshojnë sipas masës së pantallonave. Qendrat e elipseve duhet të jetë tek pika ku bashkohen katër pjesët e këmbëve.

Anët e harkuara të arnave duhet të jenë të qepura tek pantallonat me tegel linear dy gjilpërësh me distancë 2 dhe 8 mm nga buza.

Anët e drejta (të brendshme) duhet të qepen bashkë me tegelat bashkues anësore dhe qendror. Tegelat sipërfaqësore përcaktojnë edhe thellësinë e palosjes së brendshme të tekstit.

XHEPAT E PËRPARMË

Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonale. Hapja e xhepit duhet të fillojë poshtë qemerit, në një distancë 5 cm nga tegeli anësor i pantallonave dhe të përfundojë po tek tegeli anësor.

Xhepat duhet të jenë 17 cm e gjatë. Ato duhet të përforcohen në të dy ekstremitetet e tyre me traveta.

Xhepat duhet të përshkohen gjatë gjithë gjatësisë nga një tegel linear dy gjilpërësh me distancë 2 mm dhe 8 mm nga buza.


Në pjesën e dukshme (mostra) xhepat duhet të jenë të veshur me tekstil të njëjtë me pantallonat.

Astari i xhepave duhet të ketë përmasa 30 x 16 cm.

XHEPAT E PASMË

Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të pasme me fileto, kapak dhe mbyllje me elementë *velcro*, të pozicionuar rreth 5.5 cm poshtë qemerit. Kapakët dhe filetот duhet të përforcohen me frazelinë termoadezive.

Kapakët e xhepave duhet të kenë përmasa 14.5 cm x 5 cm, ndërsa filetот duhet të kenë përmasa 14.5 x 1.5 cm.




Kapakët duhet të përshkohet nga tre anët e lira me tegela perimetrale lineare dy gjilpërësh sipërfaqësorë me distancë 2 dhe 8 mm nga buzët, ndërsa rreth e përqark filetove, në një distancë prej 1 mm nga buza, duhet të qepet një tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Mbyllja e kapakëve duhet të bëhet me anë të dy elementëve *velcro* mashkull/ femër me përmasa 2.5×2 cm. Elementët *velcro* duhet të vendosen në dy cepat e xhepave, brenda tegelit perimetral.

XHEPAT E KËMBËVE

Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa me kapak me elementë *velcro*, palë të puthitur dhe tegel sipërfaqësor linear dy gjilpërësh.

Xhepat dhe kapakët duhet të kenë formë drejtkëndore të rregullt. Përmasat e xhepave duhet të jenë 23×22 cm, ndërsa përmasat e kapakëve të xhepave duhet të jenë 22.5×7 cm.



Pala e xhepave duhet të jetë e tipit e puthitur: palë e dyanshme e përmbysur dhe e kufizuar me traveta. Përmasat e palës duhet të jenë 23×4 cm.

Hapja e palës nga jashtë duhet të jetë vetëm 14 cm e gjatë dhe e përforcuar me traveta horizontale tek ekstremitetet. Traveta e poshtme duhet të qepet në distancë 3 cm nga buza e poshtme, ndërsa traveta e sipërme duhet të qepet në distancë 6 cm nga buza e sipërme. Pjesa tjetër e hapjes së palës duhet të jetë e qepur.

Xhepat duhet të përshkohet në pjesën e sipërme nga një tegel linear një gjilpërësh me distancë 2.5 cm nga buza dhe të qepen në këmbishë me anë të një tegeli sipërfaqësor linear dy gjilpërësh me distancë 2 mm dhe 8 mm nga buzët. Tek buza e sipërme, tegeli duhet të përforcohet me traveta.

Kapakët e xhepave duhet të përbëhen nga dy shtresa tekstili me përmasa të njëjta të përforcuara në brendësi me frazelinë termoadezive. Shtresa përforcuese prej frazeline termoadezive duhet të bashkohet me shtresën e sipërme në tranxhë me avull të nxehtë.

Shtresat e kapakut duhet të bashkohen me njera-tjetrën me tegel sipërfaqësor linear dy gjilpërësh. Tegeli i sipërm duhet të bëjë qepjen e kapakut tek këmbët. Ai duhet të përforcohet edhe me dy traveta kryq në secilin ekstremitet.

Xhepat duhet të pozicionohen në anën e jashtme të kofshëve, sipër gjurit, ndërsa kapakët e xhepave duhet të qepen në një distancë rreth 2.5 cm mbi xhepa.

Mbyllja e kapakëve duhet të bëhet me anë të dy elementëve *velcro* mashkull/femër me përmasa 2 x 2.5 cm. Elementët *velcro* duhet të vendosen në dy cepat e xhepave, brenda tegelit perimetral.

Kujdes! Përmasat dhe pozicionimi i xhepave mund të ndryshojnë tek masat e vogla ose të mëdha të pantallonave por pa prishur raportet e specifikuara tek ilustrimi teknik.

ASTARI

Pantallonat duhet të vishen nga brenda me astar tip rrjetë. Astar i duhet të qepet tek qemeri dhe tek fundet e këmbëve.

ASTARI I LËVIZSHËM

Pantallonat duhet të pajisen me astar të lëvizshëm me mbushje për mot të ftohtë.

Astar i lëvizshëm duhet të përbëhet nga tre shtresa: shtresa e jashtme prej tekstili methurje diagonale, mbushja me fibra poliestre dhe shtresa e brendshme (në kontakt me trupin) prej tekstili të trikotuar dhe dërstiluar.

Përveç qepjes perimetrale, shtresat duhet të qepen me njëra-tjetrën edhe me anë të tegelave lineare një gjilpërësh që krijojnë motive me rombe në të gjithë sipërfaqen. Përmasat e rombeve duhet të jenë përafërsisht 5 x 5 cm.

Astar i duhet të montohet me anë të një zinxhiri të vetëm, të hollë e të përshtatshëm për linjat e harkuara. Zinxhiri duhet të hapet nga njëra anë. Ai duhet të qepet tek filetoja e zinxhirit, e cila duhet qepur poshtë qemerit. Zinxhiri duhet të jetë i butë dhe të mos ndjehet gjatë veshjes.

XHEPAT E PLLAKAVE MBROJTËSE PËR KOSTUMET E MOTOÇIKLISTËVE

Vetëm pantallonat e kostumeve të motoçiklistëve duhet të pajisen me xhepa për vendosjen e pllakave mbrojtëse. Xhepat duhet të jenë prej rrjete, të kenë formën e pllakave dhe të qepen tek gjunjët dhe ijët.

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së kostumit duhet të jenë me hap 4 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
 - Tegelat e xhupave dhe të pantallonave duhet të jenë të termosalduara.
- Të gjithë elementët e kostumit duhet të jenë simetrik.

- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili i kostumit nuk duhet të rrudhoset.
- Membrana prej Polytetrafluoroethylene (PTFE) duhet të jetë e puthitur mirë me tekstilin e artikullit. Në sipërfaqen e saj nuk duhet të ketë flluska me diametër $\geq 4\text{mm}$.
- Kostumi duhet të jetë e lehtë për tu mirëmbajtur.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e kostumeve është $\pm 2\%$. Tek qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.
- Vendosja e perçinave në xhup duhet të bëhet rreptësisht sipas përshkrimit tek *Specifikimet Teknike*.
- Perçinat duhet të kenë pamje të rregullt. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishen ose të pësojnë dëmtime të tjera.
- Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Të gjithë artikujt e kostumit të patrullave dhe motoçiklisteve duhet të pajisen me etiketa prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes. Tek xhupi duhet të qepet një etiketë tek xhepi i brendshëm i djathtë (i veshur). Xhupi duhet të ketë një perçinë rezervë, e cila duhet të vendoset në një qese plastike prej polietileni ose prej kartoni të hollë, të mbyllur mirë. Perçina rezervë duhet të jenë të pranishme tek secili xhup. Ajo duhet të vendoset gjatë paketimit e kapur në etiketën e xhupit me një fije plastike të siguruar mirë.

Tek pantallonat duhet të qepet një etiketë në qendër të qemerit, mbrapa (në brendësi).

Në momentin e dorëzimit kostumet duhet të jenë të pastër, të hekurosur, pa njolla dhe secili artikull duhet të paketohet në një qese polietileni.

Xhupi dhe pantallonat duhet të futen bashkë në një qese tjetër polietileni.

Në çdo kuti duhet të vendosen kostume të së njëjtës masë dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë artikujsh.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m^2) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar

masa e kostumit, gjinia, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes. EN ISO 2286-2:2016 Tekstile të gomuara ose të plastifikuara - Pjesa 2: Metodat për përcaktimin e masës së përgjithshme për njësi të sipërfaqes, masës për njësi të veshjes të sipërfaqes dhe masës për njësi të shtresave
Përshkueshmëria e ujit (presioni hidrostatik)	EN ISO 4920:2012 Pëlhura tekstili - Përcaktimi i qëndrueshmërisë në njomjen sipërfaqësore (prova me sprucim) EN ISO 6330:2012 Tekstile - procedurat e larjes dhe tharjes në kushte shtëpie për testimin e tekstileve EN 20811/ EN ISO 811:2018 Tekstile - përcaktimi i qëndrueshmërisë ndaj depërtimit të ujit - testi nën presionin hidrostatik
Aftësia ajërosëse e tekstit	EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike nën ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga djersitja)
Rezistenca termike	EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike nën ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga djersitja)
Përshkueshmëria e ajrit	EN ISO 9237 Tekstilet - Përcaktimi i depërtueshmërisë së pëlhurave nga ajri

Qëndrueshmëria në tërheqje	EN ISO 1421:2016 Tekstile të gomuara ose të plastifikuara - Përcaktimi i forcës tërheqëse dhe zgjatimit në këputje
Qëndrueshmëria në grisje	EN ISO 4674-1 (A):2016 Tekstile të gomuara ose të plastifikuara -Përcaktimi i qëndrueshmërisë në grisje - Pjesa 1: Shkalla konstante e metodave të grisjes
Stabiliteti dimensional	EN ISO 3175: 2018 Tekstile - Kujdesi profesional, pastrimi i thatë dhe me lagështi i pëlhurave dhe veshjeve - Pjesa 1: Vlerësimi i performancës së provës pas pastrimit dhe procesit përfundimtar
	EN ISO 3759:2011 Tekstilet - Përgatitja, markimi dhe matja e kampioneve të pëlhurave dhe të veshjeve në provat për përcaktimin e ndryshimit të përmasave
	EN ISO 5077:2007 Tekstile - Përcaktimi i ndryshimit në larje dhe në tharje
	EN ISO 6330:2012 (6N) Tekstile - Proçedurat e larjes dhe tharjes në kushte shtëpie për testimin e tekstileve
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Rezistenca ndaj hidrokarbureve (padepërtueshmëria ndaj vajërave)	EN ISO 14419:2010 Tekstilet- Padepërtueshmëria ndaj vajërave- Testi i rezistencës ndaj hidrokarbureve
Rezistenca ndaj delaminacionit (pas 30 cikle larjesh)	EN ISO 6330:2012 (A1, 4N) Tekstile - Proçedurat e larjes dhe tharjes në kushte shtëpie për testimin e tekstileve
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur


	sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Materialet reflektive	EN ISO 20471: 2013/ A1:2016 Standardi për shiritat reflektive dhe veshjet për sigurinë në punë.
Pllakëzat mbrojtëse të kostumit	EN-13595:2002 Pjesa 2, 3, 4 Veshje mbrojtëse për motoçiklistat profesionistë - xhaketa, pantallona.
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
Ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Kapele sportive dimërore

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *kapele sportive dimërore* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349			
Pesha	250–300 gr/ m2			
	Shtresa e jashtme	tekstil i endur		
	Thurja	Ripstop		
	Përbërja	100% poliestër		
	Shtresa e brendshme	Membranë		
	Përbërja	100% Polytetrafluoroethylene (PTFE)		
	Shtresa e trete	100 % Poliestër		
Përshkueshmëria e ujit	mbi 20,000 mm			
	Fillestare	≥ ISO 5		
	pas 3 larjeve në 40°C	≥ ISO 3		
Përshkueshmëria e ujit (presioni hidrostatik)	mbi 50 mbar/ min			
Aftësia ajërosëse e tekstilit	> 15,000 gr/ m ² /24h	ajërosje shumë e mirë	Ret ≤ 7 m ² Pa/ W	
Rezistenca termike	≥ 0.030 m ² K/W			
Përshkueshmëria e ajrit	≤ 5 l/ m ² /s			
Qëndrueshmëria në tërheqje	baza	≥ 750 N	indi	≥ 600 N
Qëndrueshmëria në grisje	baza	≥ 65 N	indi	≥ 65 N
Stabiliteti dimensional	± 3% në bazë dhe në ind			
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4 – 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.		
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.		
Rezistenca ndaj hidrokarbureve (padepërtueshmëria ndaj vajërave)	Fillestare ≥ 5 Pas 3 larjesh ≥ 4 (temp 40°C, tharje ne ajër)			
Rezistenca ndaj delaminacionit (pas 30 cikle larjesh)	Nuk ka delaminacion, vrima apo flluska më të mëdha se 3 mm			
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 50,000 cikle			
Efekti pilling (kokërzimi)	nota 5			
Azo Ngjyruës	Nuk duhet të jenë të pranishëm			

pH	4.0 - 7.5
----	-----------

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.


Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se – nota 6: shumë e mirë*.


Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu nuk njollos tekstilin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonacione të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- lëkundje në gjerësi,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon cilësinë funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesoret që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *kapelë sportive*.

Astari		
	Ngjyra	e zezë
	Përbërja	90% poliestër 10% spandex
	Thurja	rrjetë
 Shirit për termosaldimin e qepjeve. Shirit për termosaldimin e qepjeve	Me 3 shtresa	poliamid PTFE shtresë termoadezive
	Ngjyra	e zezë
	Gjerësia	1-2 cm
	Trashësia	0.35 mm
	Me ajrosje të mirë dhe rezistencë të lartë ndaj ujit.	
 Tekstil për pjesën e brendshme të rrethit të kapelës.	Përbërja	100% pambuk
	Ngjyra	blu e errët ose e zezë
	Pesha	200 gr/m ²
Përforcues		

Frazelinë e hollë për rrethin e brendshëm të kapelës.		Lartësi	35 mm
		Ngjyra	e bardhë
Shirit plastik PVC me ngjyrë të zezë për përforcimin e rrethit të brendshëm të kapelës.		Gjerësia	5 mm
		Trashësia	0.5 mm
Tekstil i kollarisur adesiv për përforcimin e pjesës ballore të kupolës së kapelës.		Përbërja	100% pambuk
		Pesha	220 g/m ² ± 3%
Streha			
Shtresë plastike e harkuar me elasticitet të lartë për strehën e kapelës.		Përbërja	polivinil kloruri (PVC)
		Trashësia	± 2 mm
		Përmasat	18 x 7 cm
Filli			
Fill qepës	Përbërja	100% poliestër	
	Numri	75 Nm	
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12 N	
	Ngjyra	njësoj si kapela	
Aksesorë të tjerë			
1 një kopsë e veshur me të njëjtin tekstil si kapela.		Diametri	15 mm
Mekanizëm plastik për shtrëngimin e kapelës.		Përmasa	2 x 8 cm
		Përbërja	polivinil kloruri (PVC)
		Ngjyra	e zezë
Etiketa			
Etiketë prej tekstili për identifikimin e firmës prodhuese, masës, mirëmbajtjes dhe përbërjes.		Përbërja	100% poliestër
		Ngjyra	e bardhë
Stema			
Stema plastike		Përmasa	6 x 5 cm
		Trashësia	± 2 mm
		Përbërja	polivinil kloruri (PVC)
		Ngjyra	e artë
		Skalitje	detajet e emblemës

Stema plastike do t'u nënshtrohet testimeve të mëposhtme:

- **Rezistenca ndaj përkuljes.** Nga përkulja e lehtë disa herë e produktit, nuk duhet të shfaqen thyerje apo vrima të vogla.
- **Rezistencës ndaj ujit.** Nuk duhet të shfaqë tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur në ujë të distiluar për 24 orë në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria ndaj solucioneve larëse.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për 24 orë në ujë me solucion sapun larës 3% në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria ndaj solucioneve tretëse.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë fërkuar lehtë me furçë, me alkool etilik e më pas me benzinë.
- **Qëndrueshmëria ndaj klorurit të sodiumit.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për një orë në 1% klorurit të sodiumit në temperaturë 25°C.
- **Rezistenca ndaj degradimit.** Rezistencë ndaj degradimit, si gjatë përdorimit dhe ndaj agjenteve të jashtëm.

Produkti final do t'i nënshtrohet kontrollit fizik të thjeshtë në mënyrë që të vërtetohet plotësimi i kushteve teknike për secilin element si p.sh: që materialet e përdorura janë të përshtatshme për produktin, pamja dhe konstruksioni i përgjithshëm, stilizimi, vlerat estetike, etj. Kontrolli do të bëhet me sy të lirë dhe me mjete të caktuara.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë stema plastike, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- kokërrzim (punime të ashpra),
- tonalitete të ngjyrës,
- ndryshim në dendësi të materialit,
- deformime të imazhit të skalitur,
- shkëputje të pjesëve,
- gropëzime ose plasaritje,
- relieve jo të rregullta,
- oksidime,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon pamjen funksionale dhe estetike të produktit.

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit kapele sportive dimërore janë:

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.



1 qese polietileni për kapele

1 kuti kartoni për paketimin e kapeleve

Të gjitha mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuar.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli kapele sportive dimërore do të porositet dhe do të prodhohet në masat S - M - L dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



1	Perimetri i kokës	cm.
---	-------------------	-----

3. NGJYRA REFERENCË

Ngjyra e tekstilit të kapelës dhe aksesorëve të tjerë duhet të jetë blu e errët spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349

Ngjyra e paraqitur në këtë dokument shërben si referencë për prodhuesin. Aprovimi i saj do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampionëve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.



4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecure cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit kapele sportive dimërore.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut.

Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 100 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Frazelina

Ngjitja e frazelinës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën 150–170 °C, me kohëzgjatje 12–14 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet aplikimi i frazelinës me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

5. NDËRTIMI I KAPELES

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të kapelës sportive dimërore.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Kapela sportive duhet të jetë e tipit *baseball cap*, me mekanizëm plastik shtrëngues me kunjë. Pjesët përbërëse të saj janë:

- Kupola
- Streha
- Mekanizëm plastik shtrëngues
- Emblema

KUPOLA

Lartësia e kupolës duhet të jetë 17 cm. Ajo duhet të jetë e ndërtuar me pesë pjesë: katër pjesë trekëndore prej tekstili me përmasa të barabarta dhe pjesa ballore, e përforcuar me tekstil të kollarisur, që duhet të jetë sa dy pjesë të bashkuara.

Pjesët duhet të qepen me njëra-tjetrën me anë të tegelave lineare një gjilpërësh, ndërsa tek pjesa e ballore qepja duhet të bëhet vetëm tek buzët e lira, duke formuar kështu një pencë me gjatësi rreth 8 cm. Tegeli i pencës duhet të jetë sipërfaqësor. Të gjitha prerjet e kupolës, përfshirë dhe pencën e pjesës ballore, duhet të përshkohen nga një tegel zbukurues një gjilpërësh me largësi 2 mm. Në anën e brendshme, tegelat qepës duhet të mbulohen me shirita termosaldues.

Astari i kapelës duhet të jetë i ndërtuar njësoj si kupola. Pjesët duhet të qepen me njëra-tjetrën me anë të tegelit syzator pesë fijesh (një tegel linear dhe një tegel mbulues).

Në pikën kulmore të kupolës, atje ku puthiten këndet e të gjitha pjesëve, duhet të qepet një kopsë e veshur me të njëjtin tekstil si kapela. Astari i kapelës kapet me tekstilin e jashtëm tek kopsa.

Kapela duhet të pajiset në pjesën e pasme me mekanizëm plastik shtrëngues me kunjë.

Tek buza e poshtme perimetrale e kupolës duhet të qepet një shirit përforcues plastik me ngjyrë të errët dhe gjerësi 5 mm që ka si funksion ruajtjen e formës së kapelës.

Po tek i njëjti vend duhet të qepet edhe një shirit prej tekstili me gjerësi 3 cm. Shiriti duhet të qepet tek buza e poshtme, ndërsa buza e sipërme duhet të jetë e lirë. Shiriti duhet të jetë i përbërë nga një shtresë tekstili i prerë me kënd 45° dhe një shtresë sfungjer dhe frazelinë të ngjitura bashkë.




STREHA

Streha duhet të ketë përmasa 18×7 cm. Ajo duhet të jetë e përbërë nga një shtresë e harkuar plastike me ngjyrë të zezë dhe trashësi 2 mm e veshur me dy shtresa tekstili të njëjtë me kapelën. Shtresa plastike duhet të jetë relativisht e fortë dhe elastike.

Shtresat prej tekstili duhet të qepen me shtresën plastike nëpërmjet 4 ose më shumë tegelave lineare një gjilpërësh sipërfaqësorë me distancë 5 mm nga njëri - tjetri dhe distancë rreth 15 mm nga buza e lirë e strehës.

Streha duhet të qepet tek perimetri kupolës.



STEMA


Stema duhet të ketë përmasa 6×5 cm dhe duhet të montohet tek pjesa ballore e kapelës me ngjitje në të nxehtë.

Stema duhet të jetë prej materiali plastik me ngjyrë ari, me sipërfaqe me relief. Modeli i emblemës duhet të ketë pamjen e saj zyrtare, ashtu siç është paraqitur në ilustrimin e këtij dokumenti. Gjatë prodhimit, ajo nuk duhet të pësojë ndryshime në model, ngjyrë, raportet mes elementëve dhe në përmasa.

Montimi i stemës duhet të jetë i drejtë, i rregullt, pa deformime dhe nuk duhet të krijojë tendosje të tekstilit.



Përmasat e kapelës për masën M	
Lartësia e kupolës	17cm
Perimetri i poshtëm i kurorës	57 cm
Gjerësia e strehës	18 cm
Gjatësia e strehës përpara	7 cm



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së kapelës duhet të jenë me hap 3 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e kapelës duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e kapeles është $\pm 2\%$.
- Stema nuk duhet të pësojë ndryshime në model, ngjyrë, raporte dhe përmasa.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Kapela duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, tek e cila duhet të shkruhet emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes. Etiketa duhet të qepet tek shiriti prej tekstili, në brendësi.

Në momentin e dorëzimit kapelat duhet të jenë të pastra, dhe të rregullta. Ato duhet të palosen dhe të paketohen në qese polietileni.

Artikulli duhet të paktohet me nga 50 kapele për kuti. Në çdo kuti duhet të vendosen kapele të së njëjtës masë. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë kapelash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve.

Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e kapelës, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjytës (natriban).

ANEKSI - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes. EN ISO 2286-2:2016 Tekstile të gomuar ose të plastifikuar - Pjesa 2: Metodat për përcaktimin e masës së përgjithshme për njësi të sipërfaqes, masës për njësi të veshjes të sipërfaqes dhe masës për njësi të shtresave
Përshkueshmëria e ujit (presioni hidrostatik)	EN ISO 4920:2012 Pëlhura tekstili - Përcaktimi i qëndrueshmërisë në njomjen sipërfaqësore (prova me sprucim) EN ISO 6330:2012 Tekstile - procedurat e larjes dhe tharjes në kushte shtëpie për testimin e tekstileve EN 20811/ EN ISO 811:2018 Tekstile - përcaktimi i qëndrueshmërisë ndaj depërtimit të ujit - testi nën presionin hidrostatik

Aftësia ajërosëse e tekstilit	EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike nën ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga djersitja)
Rezistenca termike	EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike nën ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga djersitja)
Përshkueshmëria e ajrit	EN ISO 9237 Tekstilet - Përcaktimi i depërtueshmërisë së pëlhurave nga ajri
Qëndrueshmëria në tërheqje	EN ISO 1421:2016 Tekstile të gomuar ose të plastifikuara - Përcaktimi i forcës tërheqëse dhe zgjatimit në këputje
Qëndrueshmëria në grisje	EN ISO 4674-1 (A):2016 Tekstile të gomuar ose të plastifikuara -Përcaktimi i qëndrueshmërisë në grisje - Pjesa 1: Shkalla konstante e metodave të grisjes
Stabiliteti dimensional	EN ISO 3175: 2018 Tekstile - Kujdesi profesional, pastrimi i thatë dhe me lagështi i pëlhurave dhe veshjeve - Pjesa 1: Vlerësimi i performancës së provës pas pastrimit dhe procesit përfundimtar
	EN ISO 3759:2011 Tekstilet - Përgatitja, markimi dhe matja e kampioneve të pëlhurave dhe të veshjeve në provat për përcaktimin e ndryshimit të përmasave
	EN ISO 5077:2007 Tekstile - Përcaktimi i ndryshimit në larje dhe në tharje
	EN ISO 6330:2012 (6N) Tekstile - Procedurat e larjes dhe tharjes në kushte shtëpie për testimin e tekstileve
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me

	llambë me hark ksenoni
Rezistenca ndaj hidrokarbureve (padepërtueshmëria ndaj vajërave)	EN ISO 14419:2010 Tekstilet- Padepërtueshmëria ndaj vajërave- Testi i rezistencës ndaj hidrokarbureve
Rezistenca ndaj delaminacionit (pas 30 cikle larjesh)	EN ISO 6330:2012 (A1, 4N) Tekstile - Proçedurat e larjes dhe tharjes në kushte shtëpie për testimin e tekstileve
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
Ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Dorashka motoçiklisti

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që do të përdoret për prodhimin e artikullit *dorashka motoçiklisti* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349		
Përbërja	100% poliamid veshur me shtresë poliuretani		
Thurja	garniturë		
Masa gr/m ² (± 5%)	240 gr/m ²		
Depërtueshmëria e ujit	mbi 10,000 mm	≥ ISO 5	
Aftësia ajërosëse e tekstilit	mbi 10,000 gr/m ² /24h	ajrosje e mirë	Ret ≤ 7
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4 - 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.	
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.	
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 25000 cikle		
Efekti pilling (kokërzimi)	nota 5		
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm		
pH	4.0 - 7.5		

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme* - nota 4 dhe *shumë e qëndrueshme* - nota 5. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se* - nota 6; *shumë e mirë*.


Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë të zezë do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra e zezë nuk transferohet tek tekstili i bardhë.


Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elemente *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,

- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cënon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesoret që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *dorashka motoçiklisti*.

Astar		
Astari për dorashkën.	Ngjyra	e zezë
	Përbërja	100% Poliester
	Thurja	trikotazh i dërstiluar (<i>fleece</i>)
Përforcues		
Shtresë prej lëkure jastëkun e pëllëmbës.	Ngjyra	e zezë
	Përbërja	lëkurë gjedhi
	Regjja	kromike
Shtresë për veshjen e gishtave dhe pëllëmbëve. 	Përbërja	kamosh (lëkurë gjedhi)
	Ngjyra	e zezë
Shtresë prej poliuretani për jastëkët në kurriz dhe pëllëmbë.	Ngjyra	e verdhë
Shtresë mbrojtëse për veshjen e jastëkut të kurrizit. 	Përbërja	<i>Kevlar</i>
	Ngjyra	e zezë
	Tipi	rrjetë
Aksesorë plastikë		
Unazë plastike për kalimin e rripit të shtrëngimit të dorashkës. 	Ngjyra	e zezë
	Përbërja	Polivinil Kloruri
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet	Përbërja	100% poliester
	Numri metrik	50 Nm ± 5%
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	njësoj si tekstili

Shirit reflektiv		
Shirit reflektiv 	Ngjyra	gri argjendi
	Gjerësia	3 cm
	Përbërja	100% poliamid
	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit ISO 20471:2013	
	Materiali duhet t'i rezistojë mbi 105 cikleve të larjes në kushte shtëpie me temperaturë 60 °C.	
	I dukshëm në distancë deri në 150 m.	
Velcro		
Element <i>Velcro</i> femër/mashkull, për shtrëngimin e dorashkës. 	Përmasat e elementëve <i>velcro</i>	7.5 x 2 cm
	Përbërja	100% fibra poliamide
	Trashësia e dy shiritave të bashkuar	± 3 mm
	Masa lineare	41 g/m ± 5%
	Ngjyra	njësoj si jeleku
	Trashësia e elementit <i>femër</i>	2.2 mm
	Trashësia e elementit <i>mashkull</i>	1.6 mm
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme	
	E ftohtë	- 30 °C
	E nxehtë	pika e dobësimit: 180 °C
		pika e shkrirjes: 210 – 250 °C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës	
Në larje	jo më pak se 3	
Në ujë të nxehtë		
Në djersë		
Në fërkim		
Llastik		
Llastik 	Përbërja	100 % poliester
	Ngjyra	e zezë
	Gjerësia	0.5 cm
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për identifikimin e firmës prodhuese, për mirëmbajtjen dhe lëndën e parë.	Përbërja	100% poliester
	Ngjyra	e zezë

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *dorashka motociklisti*

Qese polietileni për paketimin e një palë dorashkave.

Kuti kartoni për paketimin e dorashkave.

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuar.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.


2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *dorashka e motoçiklistit* do të porositet dhe do të prodhohet në masat S-M-L-XL për femrat dhe S-M-L-XL për meshkujt dhe sasitë që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore


Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:

Për femra			
16 - 17.5 cm	18 - 20.5 cm	21 - 22 cm	22.5 - 23.5 cm
S	M	L	XL
Për meshkuj			
18.5 - 21 cm	21.5 - 23 cm	23.5 - 25.5	26 - 28 cm
S	M	L	XL



Perimetri i pëllëmbës duhet të matet në pjesën më të gjerë të saj, kur pëllëmba është e hapur. Matja duhet bërë tek të dyja duart dhe për bazë do të merret masa më e madhe.

3. NGJYRAT REFERENCË



Tekstili i dorashkave duhet të jetë ngjyrë blu e errët spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349 Shtresat përforcuese dhe aksesorët duhet të jenë me ngjyrë të zezë spektri sipas CIELCH 17, 2.875, 65.882.

Shiriti reflektiv duhet të jetë me ngjyrë gri spektri sipas CIELCH 73, 0.743, 200.028.

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *dorashka motoçiklisti*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përberëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhueshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Procesi i prerjes duhet të bëhet me shumë kujdes për një shfrytëzim optimal të materialit. Buzët e detajeve të prera duhet të jenë të pastra sidomos në pjesët e harkuara. Dorashkat e një pale duhet të priten nga e njëjta lëkurë për të shmangur tonalitetet në ngjyrë.

Markimi i pjesëve përberëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonalitet.

5. NDËRTIMI I DORASHKAVE

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të dorashkave.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Shembull për referencë

Dorashkat e motoçiklistëve duhet të jenë identike për të dyja gjinitë.
Pjesët përbërëse të dorashkës:

- pjesa e kurrizit dhe e pëllëmbës
- gishti i madh
- shiritat mes gishtave
- rripi shtrëngues
- shtresat prej kamoshi
- astari

Dorashkat e motoçiklistit duhet të jenë kryesisht ngjyrë blu e errët, prej tekstili poliamidi, me pjesë shtesë mes gishtave. Pjesët e qepura nuk duhet të kenë tërheqje ose rrudha.

Qafat e dorashkave duhet të jenë të larta rreth 7–8 cm mbi kyç. Ato duhet të pajisen me rrip/rripa shtrëngues me fiksues *Velcro* nga jashtë, llastik të brendshëm tek kyçet dhe elementë reflektivë fluoreshent.

Dorashkat duhet të pajisen tek kurrizi dhe pëllëmbët me jastëkë sfungjeri prej poliuretani. Jastëku i kurrizit duhet veshur me tekstil *Kevlar*, ndërsa jastëku i pëllëmbës duhet veshur me lëkurë me ngjyrë të zezë.

Pëllëmbët dhe gishtat duhet të jenë pjesërisht të veshura me shtresë përforcuese prej kamoshi me ngjyrë të zezë.

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Dorashkat duhet të jenë të qepura mirë dhe të duken të rregullta kur të vishen nga punonjësit e Policisë së Shtetit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzaktësisht karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së dorashkave duhet të jenë me hap 4 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, dhe simetrikë, dhe nuk duhet të kenë shqepje ose difekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12 N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e dorashkave duhet të jenë simetrikë.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Dorashkat duhet të kenë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj depërtueshmërisë së erës dhe ujit dhe të sigurojë ajërim të trupit.
- Tekstilet, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me çertifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Dorashkat duhet të pajisen me një etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa duhet të qepet në qendër të qafës së dorashkës. Etiketa duhet të jetë e palosur. Në njërin anë duhet të shënohen instruksionet e mirëmbajtjes: hekurosja, larja, tharja, etj. Në anën tjetër duhet të shënohet ky informacion: emri i firmës prodhuese, viti i prodhimit, emri i artikullit, masa dhe gjinia.

Në momentin e dorëzimit dorashkat duhet të jenë të pastra, të palosur dhe pa njolla.

Dorashkat e palosura një e majtë dhe një e djathtë duhet të futen në një qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen dorashka të së njëjtës masë dhe gjini. Çdo kuti duhet të ketë një sasi të barabartë dorashkash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e dorashkave, viti i prodhimit, sasia dhe emri i kompanisë furnizuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes. EN ISO 2286-2:2016 Tekstile të gomuar ose të plastifikuara - Pjesa 2: Metodat për përcaktimin e masës së përgjithshme për njësi të sipërfaqes, masës për njësi të veshjes të sipërfaqes dhe masës për njësi të shtresave
Përshkueshmëria e ujit (presioni hidrostatik)	EN ISO 4920:2012 Pëlhura tekstili - Përcaktimi i qëndrueshmërisë në njomjen sipërfaqësore (prova me sprucim) EN 20811/ EN ISO 811:2018 Tekstile - përcaktimi i qëndrueshmërisë ndaj depërtimit të ujit - testi nën presionin hidrostatik
Aftësia ajërosëse e tekstilit	EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike nën ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga djersitja)

Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle te larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Materialet reflektive	EN ISO 20471: 2013/ A1:2016 Standardi për shiritat reflektivë dhe veshjet për sigurinë në punë.
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
Ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TE DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Xhup me vizibilitet të lartë

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *xhup me vizibilitet të lartë* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	e gjelbërt (green lime) spektri sipas CIELCH 79, 89.881, 119.910		
Përbërja	100% <i>poliamid</i>	e veshur me shtresë poliuretani	
Thurja	Oxford		
Masa (± 5%)	155 gr/m²		
Përshkueshmëria e ujit	mbi 20,000 mm	≥ ISO 5	
Përshkueshmëria e ujit (presioni hidrostatik)	mbi 50 mbar/min		
Aftësia ajërosëse e tekstilit	mbi 15,000 gr/m²/24h	ajërosje shumë e mirë	Ret ≤7
Përshkueshmëria e ajrit	≤ 5 l/m²/s		
Hollesia e fije	300D * 300D		
Rezistenca ndaj hidrokarbureve (padepërtueshmëria ndaj vajërave)	Fillestare ≥ 5 Pas 3 larjesh ≥ 4(temp 40°C, tharje ne ajër)		
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.	
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.	
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 50,000 cikle		
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 5		
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm		
pH	4.0 - 9.0		
Kujdes! Tekstili nuk duhet të ketë aroma të pakëndshme dhe nuk duhet të jetë i ashpër.			

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstileve të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të


jetë: e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: jo më pak se – nota 6: shumë e mirë.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në ofertën teknike do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstit me ngjyrë të gjelbërt do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra e gjelbërt nuk njollos tekstin e bardhë.


Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elementë *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesoret që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit xhup me vizibilitet të lartë:

Astarët			
Astar në formë rrjete për xhupin. 	Përbërja	90% poliestër	10% <i>spandex</i>
	Pesha	90 gr/m ²	
	Ngjyra	e gjelbër	
	Thurja	trikotazh rrjetë	
Astar për xhepat dhe mëngët e xhupit.	Përbërja	50% pambuk	50% poliestër
	Pesha	80 gr/m ²	
	Ngjyra	e gjelbër	
	Thurja	diagonale	
Përforcues			
Frazelinë termoadezive me ngjyrë të errët për jakën, kapakët e xhepave dhe bordurën e perçinave.			
Aksesorë të tjerë			
Element <i>Velcro</i> femër/mashkull për xhepat.	Përmasat <i>Velcro</i> , xhepat		2.5 x 2 cm
	Përbërja		100% fibra poliamide
	Trashësia		2.2 mm
	Masa lineare		41 g/m ± 5%
	Ngjyra		njësoj si xhupi
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
	E ftohtë		- 30° C
E nxehtë	pika e dobësimit	180° C	

	pika e shkrirjes		210 – 250° C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		
	Në larje	jo më pak se 3	
	Në ujë të nxehtë		
	Në djersë		
Në fërkim			
Shirit për termosaldimin e qepjeve kryesore të xhupit. Shirit per termosaldimin e qepjeve 	Me 3 shtresa	Poliamid	
		PTFE	
	Ngjyra	shtresë termoadezive	
	Gjerësia	e bardhë	
	Trashësia	2 cm	
	0.35 mm		
	Me ajrosje të mirë dhe rezistencë të lartë ndaj ujit.		
Filli			
Fill qepës për qepjet primare dhe të dukshme.	Përbërja	100% poliester	
	Numri metrik	50 Nm ± 5%	
	Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes	jo më pak se 12 N	
	Ngjyra	njësoj si xhupi	
Fill qepës për qepjet dytësore (astari i xhepave, astarët e xhupit etj.).	Përbërja	100% poliester	
	Numri metrik	75 Nm± 5%	
	Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes	jo më pak se 12 N	
	Ngjyra	njësoj si xhupi	
Perçina			
	6 copë Nr. 27 (d 17 mm) + 1 rezervë		
	Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri)	
	Ngjyra	e zezë pa shkëlqim	
	Kujdes! Perçina duhet të jetë e përshtatshme për tekstinin e produktit ku do të montohen.		
Zinxhiri			
Zinxhir për mbylljen e xhupit. 	Standard, me fund të hapur, me rezistencë maksimale ndaj ujit		
	Madhësia e dhëmbëzave	8 VS ose 10VF	
	Shiriti prej tekstili	100% poliester	
	Dhëmbët	100% acetal	
	Ngjyra	e gjelbër	
Etiketa			

Etiketë prej tekstili për identifikimin e fabrikës, masës, gjinisë, mirëmbajtjes dhe përbërjes.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë
Stampa reflektive		
Stampë reflektive përpara 	Ngjyra	gri, argjend
	Lloji i bojës	reflektive
	Përmasat referencë	10 x 2 cm
	Lloji i germës	<i>Myriad Pro Bold</i>
Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjeje.		
Shkrimi POLICIA, mbrapa. Stampë reflektive mbrapa 	Ngjyra	gri, argjend
	Lloji i bojës	reflektive
	Përmasat referencë	35 x 10,5 cm
	Lloji i germës	<i>Myriad Pro Bold</i>
Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjeje.		
Stampë reflektive në formë shiritash 	Ngjyra	gri
	Gjerësia	5 cm
Përbërja		100 % poliestër
Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit EN ISO 20471		
Materiali duhet t'i rezistojë mbi 105 cikleve të larjes në kushte shtëpie me temperaturë 60 °C.		
Shiritat e stampuar duhet të duken nga një distancë prej mbi 150 m.		

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *xhup me vizibilitet të lartë*:

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.



1 kuti kartoni për paketimin e xhupave.

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli xhup me vizibilitet të lartë do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS–XXXL për femra dhe në masat S–XXXL për meshkuj, dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



Meshkuj			Femra		
2	Perimetri i qafës	cm.	2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.	3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.	4	Perimetri i krahavorit (poshtë gjoksti)	cm.
5	Perimetri në pjesën e barkut	cm.	5	Perimetri i belit	cm.
6	Perimetri i muskullit të krahut	cm.	6	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
7	Perimetri i kyçit të dorës	cm.	7	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
10	Gjatësia e plotë	cm.	8	Lartësia nga supi në gjoks	cm.
11	Lartësi e përgjithshme e trupit mbrapa (nga supi në tokë)	cm.	10	Perimetri i krahut	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale deri tek vija e belit)	cm.	11	Perimetri i kyçit të dorës	cm.
13	Gjatësia e mes shpatullave	cm.	12	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.
14	Gjatësia nga supi tek bërryli	cm.	13	Lartësia nga vija e belit në vijën e kockës abdominale	cm.
15	Gjatësia e krahut, nga supi tek kyçi i dorës	cm.	14	Lartësia e pjesës abdominale (nga vija e belit në vijën e vitheve)	cm.
16	Lartësia e pjesës nga vija e supit tek vija e	cm.	17	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale	cm.

	belit		në vijën e belit)	
		18	Lartësi e përgjithshme e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në tokë)	cm.
		19	Gjatësia e supit	cm.
		20	Gjatësia nga supi në brryl	cm.
		21	Gjatësia e krahut, nga supi në kyçin e dorës.	cm.
		25	Gjatësia e personit	cm.

3. NGJYRAT REFERENCË

Ngjyra e gjelbërt spektri sipas CIELCH 79, 89.881, 119.910 për tekstilin e xhupit, astarëve, zinxhirëve dhe elementëve *velcro*.

Ngjyra gri e argjendtë, spektri sipas CIELCH 73, 0.743, 200.028 për stampat reflektive.

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.



Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecure cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *xhup me vizibilitet të lartë*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 80 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Aplikimi i frazelinës

Ngjitja e frazelinës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën 130–140 °C, me kohëzgjatje 8–10 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet aplikimi i frazelinës me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

5. NDËRTIMI I XHUPIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të xhup me vizibilitet të lartë.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Xhupat me vizibilitet të lartë për femra dhe për meshkuj janë identikë përveç masave, të cilat duhet të jenë sipas gjinive. Gjatësia e xhupit duhet të jetë deri te gjuri.

Pjesët përbërëse të xhupit:

- Jaka
- Dy pjesët e përparme
- Pjesa e pasme
- Mëngët
- Dy xhepa të përparmë
- Xhepi i gjoksit
- Shiritat reflektivë të stampuar
- Stamat

JAKA

Jaka e xhupit duhet të jetë në formë rrethore, rreth 8 cm e lartë. Ajo duhet të përbëhet nga dy shtresa me tekstil të njëjtë (si xhupi), e përforcuar me frazelinë termoadezive.

Buzët e jakës duhet të përshkohen nga tre tegela lineare perimetrale një gjilpërësh sipërfaqësorë: një tegel në buzën e sipërme dhe dy tegela në buzën e poshtme.

PJESËT E PËRPARME

Mbyllja e xhupit duhet të bëhet me anë të zinxhirit. Zinxhiri duhet të jetë i mbuluar me bordurë me gjerësi rreth 5 cm, për tu mbrojtur nga era. Bordura duhet të mbyllet me anë të 6 perçinave metalike.

Buzët e bordurës (tek mbyllja) duhet të përshkohen nga një tegel linear vertikal sipërfaqësor një gjilpërësh.

XHEPAT E PËRPARMË

Xhupi duhet të pajiset me dy xhepa të brendshëm me kapak. Kapakët duhet të përbëhen nga dy shtresa me tekstil të njëjtë (si xhupi), të përforcuara me frazelinë termoadezive.

Buzët e lira të kapakut të xhepit duhet të përshkohen nga tegela lineare perimetrale një gjilpërësh sipërfaqësorë. Kapakët e xhepave duhet të jenë me përmasa rreth 20 x 6 cm. Astarët e xhepave duhet të jetë me përmasa 20 x 25 cm.

Mbyllja e xhepave duhet të bëhet me element *Velcro* femër/mashkull.

Kujdes! Përmasat e xhepave mund të ndryshojnë tek masat e mëdha dhe tek masat e vogla.

XHEPI I GJOKSIT

Xhupi duhet të pajiset me një xhep tip *cargo* në gjoks me përmasat e përshtatshme për transportin e radiove në përdorim nga Policia e Shtetit.

PJESA E PASME

Mbrapa, xhupi duhet të ketë një pjesë të vetme. Në pjesën e pasme duhet të qepen shiritat reflektivë dhe të stampohet fjala POLICIA me bojë reflektive.

Fundi i xhupit. Në fund xhupi duhet të mbyllet me një palosje të dyfishtë me lartësi rreth 2 cm, të qepur me tegel linear një gjilpërësh.

MËNGËT

Mëngët duhet të ndërtohen me një pjesë të vetme dhe në fund të mbyllen me një bordurë me lartësi rreth 2 cm të palosur dy herë në vetvete dhe e qepur me tegel linear një gjilpërësh.

SHIRITAT REFLEKTIVË.

Xhupi duhet të pajiset me dy shirita reflektivë të stampuar përgjatë perimetrit tërthor të trupit, dy shirita reflektivë të stampuar në mënyrë vertikale tek zona e klavikulës dhe shpatullave dhe dy shirita perimetralë tek krahët. Shiritat duhet të jenë 5 cm të gjerë. Stampimi duhet të jetë prej materiali reflektiv fluoreshent ngjyrë gri. Stampa duhet të jetë e cilësisë më të lartë. Stampa duhet të jetë e rregullt, uniforme dhe e aplikuar sipas ilustrimit teknik. Ajo nuk duhet të fshihet apo të humbasë efektin reflektiv gjatë përdorimit, nuk duhet të pësojë plasaritje apo dëmtime të tjera.

ASTARI

Xhupi duhet të vishet tek pjesa e trupit me astar në formë rrjete dhe tek mëngët me astar prej tekstili. Astar duhet të qepet tek paramontura.



SHKRIMI “POLICIA”, PËRPARA.

Në pjesën e përparme të xhupit, në anën e djathtë të gjoksit, duhet të stampohet fjala POLICIA. Përmasat e shkrimit duhet të jenë për të dyja gjinitë njësoj, 10 x 2 cm. Stampa duhet të pozicionet 0.5 cm mbi xhepin e gjoksit.

Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i germës. Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i germës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampimi duhet të jetë prej materiali reflektiv fluoreshent ngjyrë gri, si shiriti reflektiv.

Stampë reflektive përpara



SHKRIMI “POLICIA”, MBRAPA.

Në pjesën e pasme të xhupit, në qendër të shpatullave, duhet të stampohet fjala POLICIA. Përmasat e shkrimit duhet të jenë për të dyja gjinitë njësoj, 35 x 10.5 cm.

Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i germës.

Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i germës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampimi duhet të jetë prej materiali reflektiv fluoreshent ngjyrë gri. Stampa duhet të jetë e cilësisë së parë dhe të mos e humbasë efektin reflektiv gjatë përdorimit.



Kujdes! Përmasat e stampave mund të ndryshojnë (proporcionalisht) tek masat e vogla dhe tek masat e mëdha.

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së produktit duhet të jenë me hap 4 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
 - Tegelat qepës tek gavaturat e mëngëve, pjesa e supeve, para dhe pas duhet të jenë të termosalduara.
- Të gjithë elementët e produktit duhet të jenë simetrikë.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili i produktit nuk duhet të krijojë rrudha gjatë përdorimit.
- Produkti duhet të jetë i lehtë për tu mirëmbajtur.
- Produkti duhet ti rezistojë mbi 25 larjeve në kushte shtëpie me temperaturë 60°C pa pësuar ndryshime.

- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e produktit është $\pm 2\%$. Tek qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.
- Vendosja e perçinave duhet të bëhet rreptësisht sipas përshkrimit tek *Specifikimet Teknike*.
- Perçinat duhet të kenë pamje të rregullt. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishen ose të pësojnë dëmtime të tjera.
- Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Artikulli *xhup me vizibilitet të lartë* duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, gjinia, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Kjo etiketë duhet të qepet në brendësi të xhupit, tek astari, në anën e majtë, rreth 20 cm nga fundi i xhupit. Po në këtë etiketë duhet të vendoset edhe perçina rezervë. Perçina rezervë duhet të vendoset në një qese plastike polietileni ose prej kartoni të hollë, të mbyllur mirë. Perçina rezervë duhet të jetë e pranishme tek secili xhup.

Në momentin e dorëzimit xhupat duhet të jenë të pastër, të hekurosur dhe pa njolla. Xhupat e palosur duhet të futen në qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen xhupa të së njëjtës masë dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë një sasi të barabartë xhupash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e xhupit, gjinia, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.

	EN ISO 2286-2:2016 Tekstile të gomuara ose të plastifikuara - Pjesa 2: Metodat për përcaktimin e masës së përgjithshme për njësi të sipërfaqes, masës për njësi të veshjes të sipërfaqes dhe masës për njësi të shtresave
Përshkueshmëria e ujit (presioni hidrostatik)	EN ISO 4920:2012 Pëlhura tekstili - Përcaktimi i qëndrueshmërisë në njomjen sipërfaqësore (prova me sprucim) EN 20811/ EN ISO 811:2018 Tekstile - përcaktimi i qëndrueshmërisë ndaj depërtimit të ujit - testi nën presionin hidrostatik
Aftësia ajërosëse e tekstit	EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike në ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga djersitja)
Përshkueshmëria e ajrit	EN ISO 9237 :1995 Tekstilet - Përcaktimi i depërtueshmërisë së pëlhurave nga ajri
Hollesia e fijeve	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura
Rezistenca ndaj hidrokarbureve (padepërtueshmëria ndaj vajërave)	EN ISO 14419:2010 Tekstilet- Padepërtueshmëria ndaj vajërave- Testi i rezistencës ndaj hidrokarbureve
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi.
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e

	modifikuar Martindale
Materialet reflektive	EN ISO 20471: 2013/ A1:2016 Standardi për shiritat reflektive dhe veshjet për sigurinë në punë.
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Mushama shiu

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që do të përdoret për prodhimin e artikullit *mushama shiu* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	Blu të errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349		
Përbërja %	100% poliamid	e veshur me shtresë poliuretani	
Thurja	Oxford		
Masa gr/m² (± 5 %)	130gr/m²		
Hollesia e fijos (± 5 %)	210D * 210D		
Pershkueshmeria e ujit	mbi 20,000mm	≥ ISO 5	
Aftësia ajërosëse e tekstilit	mbi 15,000 gr/m²/24h	ajërosje shumë e mirë	Ret ≤ 6
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4 - 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.	
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.	
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 50000 cikle		
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 5		
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm		
pH	4.0 - 9.0		
Kujdes! Tekstili nuk duhet të ketë aroma të pakëndshme dhe nuk duhet të jetë i ashpër.			

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme* - nota 4 dhe *shumë e qëndrueshme* - nota 5. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se* - nota 6: *shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu nuk transferohet tek tekstili i bardhë.


Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elementë *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,

- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cënon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *mushama shiu*.

Astarë			
Astar për xhepat	Përbërja	E zezë	
	Ngjyra	100% poliestër	
Aksesorë të tjerë			
Elementë <i>Velcro</i> femër - mashkull 	Përmasat <i>velcro</i> për gjuhëzën e jakës		4 cm x 2 cm
	Përbërja		100% fibra poliamide
	Trashësia		2.2 mm
	Masa lineare		41 g/m ± 5%
	Ngjyra		njësoj si tekstili
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
	E ftohtë		- 30 °C
	E nxehtë	pika e dobësimit	180 °C
		pika e shkrirjes	210 – 250 °C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		
	Në larje		jo më pak se 3
	Në ujë të nxehtë		
	Në djersë		
	Në fërkim		
Shirit për termosaldimin e qepjeve kryesore të mushamasë.			
Shirit per termosaldimin e qepjeve 			
Shirit duhet të jetë me 3 shtresa:			
– poliamid, – PTFE, – shtresë termoadesive			
Ngjyra:		si tekstili	
Gjerësia:		2 cm	
Trashësia:		0.2 mm	
Shirit duhet të ketë ajërosje dhe rezistencë të lartë ndaj ujit.			
Filli			
Fill qepës për të gjitha qepjet, duhet të ketë këto të dhëna		Përbërja:	100% poliamid
		Numri metrik	80 Nm

teknike:	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12 N
	Ngjyra	njësoj si tekstili
Perçina		
Perçina 	10 copë + 1 rezervë	Nr. 27 (d 17 mm)
	Përbërja:	Tunxh (material aliazh bakër + zink)
	Ngjyra e perçinës:	Blu e erret pa shkëlqim.
	Kujdes! Perçina duhet të jetë e përshtatshme për tekstin e produktit ku do të aplikohet.	
Shirit reflektiv		
Shirit reflektiv: 	Ngjyra	gri argjendi
	Gjerësia	5 cm
	Përbërja	100 % poliamid
	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit EN ISO 20471	
	Shiriti duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjeje në kushte shtëpie me temperaturë 60 °C.	
Shiriti duhet të duket nga një distancë prej mbi 150 mt		
Llastik tubolar		
Llastik tubolar me element plastikë, për kapuçin e mushamasë. 	Përbërja e llastikut	100% poliestër
	Përbërja e elementëve plastik	100% PVC
	Ngjyra	e zezë
	Perimetri	3 mm
	Etiketa	
Etiketë prej tekstili për identifikimin e firmës prodhuese, masës, mirëmbajtjes dhe lëndës së parë.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë

c. Procese stampimi për artikullin *mushama shiu*:

Stampë fluoreshente		
Shkrimi POLICIA, mbrapa Stampë reflektive mbrapa 	Ngjyra	Gri argjendi fluoreshente
	Përmasat	10.5 x 35 cm
	Lloji i germës	Myriad Pro Bold

d. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *mushama shiu*

Fotografitë e mëposhtme shërbejnë vetëm si shembull ilustrues.



Të gjithë mjetet dhe aksesoret mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *mushama shiu* do të porositet dhe do të prodhohet në masat: XS - 4XL në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit. Mushamaja duhet të jetë e llojit *unisex*.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



Meshkuj			Femra		
2	Perimetri i qafës	cm.	2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.	3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.	4	Perimetri i krahavorit (poshtë gjoksit)	cm.
5	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.	5	Perimetri i belit	cm.
6	Perimetri i muskulit të krahut	cm.	6	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
10	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.	7	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.	8	Lartësia nga supi në gjoks	cm.
13	Gjatësia e shpatullës (mbrapa)	cm.	9	Distanca mes gjokseve	cm.
14	Gjatësia nga supi në brryl	cm.	10	Perimetri i muskulit të krahut	cm.
15	Gjatësia e krahut, nga supi në kyçin e dorës	cm.	12	Lartësia perpara nga supi në vijën e belit	cm.
16	Lartësia perpara nga supi në vijën e belit	cm.	13	Lartësia nga vija e belit në vijën e kockës abdominale	cm.
	Gjatësia e supit	cm.	17	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
			19	Gjatësia e supit	cm.
			20	Gjatësia nga supi në brryl	cm.
			25	Gjatësia nga koka tek këmbët	cm.

3. NGJYRAT REFERENCË

Ngjyra blu **spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349** për tekstilin e mushamasë.

Ngjyra gri **spektri sipas CIELCH 73, 0.743, 200.028** për shiritin reflektiv (fluoreshent)

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampionëve.



Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *mushama shiu*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhueshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 100 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e mushamasë të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonalitete të dukshme.

5. NDËRTIMI I MUSHAMASË

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të mushamasë së shiut

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Mushamaja e shiut duhet të ketë prerje pardesyje dhe duhet të qepet me tekstil prej najloni të padepërtueshëm nga uji dhe era.

Pjesët përbërëse të mushamasë:

- Dy pjesët e përparme
- Pjesa e pasme
- Jaka
- Dy mëngë të gjata të tipit *raglan*
- Një kapuç i lëvizshëm

Mushamaja e shiut duhet të përmbushë standardet ndërkombëtare për përdorim nga punonjësit e policisë ose të sigurisë. Ajo duhet të jetë e pajisur me shirita fluoreshentë ngjyrë gri të hapur për vizibilitet të lartë tek trupi dhe krahët.

Të gjithë tegelat qepës të mushamasë duhet të përforcohen me shirita me termosaldim.

Jaka e mushamasë duhet të jetë 10 cm e lartë. Ajo duhet të jetë me gjuhëz dhe mbyllja e saj duhet të bëhet me element velcro femer/mashkull. Përmasat e gjuhëzës duhet të jenë 10 x 2.5 cm, ndërsa ato të elementit velcro 4 x 2 cm.

Mbyllja e mushamasë duhet të bëhet me anë të 5 perçinave metalike. Bordura e perçinave duhet të jetë e mbuluar me kapak me gjerësi 6 cm. Buza e kapakut duhet të përshkohet nga një tegel linear një gjilpërësh me distancë 5 mm.

Mbi kapak duhet qepur shiriti reflektiv me gjerësi 5 cm.

Xhepat. Mushamaja duhet të pajiset me dy xhepa të brendshëm me kapak me gjerësi 19 cm. Përmasat e astarit të xhepit duhet të jenë 19 x 20 cm.

Kapuçi duhet të kapet tek jaka me 3 perçina metalike. Kapuçi duhet të jetë i pajisur me elastik tubolar dhe me rregullator plastik për shtrëngimin e tij.

Mëngët duhet të jenë të llojit *raglan* dhe të qepen me trupin me tegel linear një gjilpërësh. Mëngët duhet të pajisen me perçina tek parakrahët për shtrëngim.

Tek zona e manshetave duhet të qepet shiriti reflektiv me gjerësi 5 cm.

Mëngët dhe fundi i mushamasë duhet të mbyllen me një palosje të brendshme me lartësi 2 cm me tegel linear një gjilpërësh.

SHKRIMI “POLICIA”, MBRAPA

Në pjesën e pasme të mushamasë, në shpinë, duhet të vendoset shkrimi POLICIA. Shkrimi duhet të jetë i vendosur në një distancë rreth 20 cm poshtë jakës (kapuçi i ulur nuk duhet të mbulojë shkrimin).

Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara tek lloji i germës. Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i germës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Stampimi duhet të jetë i cilësisë më të lartë. Stampa duhet të jetë e rregullt, uniforme dhe e aplikuar sipas ilustrimit teknik. Gjatë përdorimit të mushamasë stampa nuk duhet të pësojë plasaritje apo dëmtime të tjera.

Stampë reflektive mbrapa

35 cm

10.5 cm

POLICIA

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes të mushamasë duhet të jenë me hap 5 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrikë dhe nuk duhet të kenë shqepje ose difekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12 N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
 - Tegelat qepës duhet të jenë me termosaldim.
- Të gjithë elementët e mushamasë duhet të jenë simetrikë.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë veti hidrofobike.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përshkueshmërisë së erës dhe ujit dhe të sigurojë ajërim të mirë të trupit. (EN 343 klasa 3)
- Mushamaja duhet të jetë e lehtë për tu mirëmbajtur.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e mushamasë është $\pm 2\%$.
- Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Mushamaja duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa duhet të qepet poshtë, në anën e djathtë të mushamasë, tek tegeli që bashkon pjesën e përparme dhe pjesën e pasme të saj. Etiketa duhet të jetë e palosur. Në njërën anë duhet të shënohen instruksionet e mirëmbajtjes dhe në anën tjetër duhet të shënohet ky informacion: emri i firmës prodhuese, viti i prodhimit, emri i artikullit, masa dhe gjinia.

Një perçinë rezervë do të futet në një qese të vogël polietileni dhe do të kapet me një shirit të hollë plastik, në etiketën e mirëmbajtjes.

Në momentin e dorëzimit mushamatë duhet të jenë të pastra, pa njolla dhe të palosura.

Mushamaja e palosur duhet të futet në një qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen mushama të së njëjtës masë. Çdo kuti duhet të ketë një sasi të barabartë mushamash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e mushamasë, viti i prodhimit, sasia dhe emri i kompanisë furnizuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluar me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testeve

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Hollësia e fijeve	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes. EN ISO 2286-2:2016 Tekstile të gomuar ose të plastifikuara - Pjesa 2: Metodat për përcaktimin e masës së përgjithshme për njësi të sipërfaqes, masës për njësi të veshjes të sipërfaqes dhe masës për njësi të shtresave
Përshkueshmëria e ujit (presioni hidrostatik)	EN ISO 4920:2012 Pëlhura tekstili - Përcaktimi i qëndrueshmërisë në njomjen sipërfaqësore (prova me sprucim) EN 20811/ EN ISO 811:2018 Tekstile - përcaktimi i qëndrueshmërisë ndaj depërtimit të ujit - testi nën presionin hidrostatik
Aftësia ajërosëse e tekstilit	EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike nën ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga djersitja)
	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle të larjes)

Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Materialet reflektive	EN ISO 20471: 2013/ A1:2016 Standardi për shiritat reflektive dhe veshjet për sigurinë në punë.
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

KOLAUDIMI

Policia e Shtetit ka të drejtën që të garantojë cilësinë e produktit final nëpërmjet një mekanizmi kontrolli që quhet *kolaudim*. Kolaudimi përfshin këto masa:

1. Verifikimi i fletë-analizës së tekstileve.
2. Matjet dhe provat fizike të aksesorëve të plotë ose elementëve individualë të tyre.
3. Krahasimin e rezultateve të matjeve me specifikat e përcaktuara në dokumentin e *Specifikimeve Teknike*.

Vetëm pasi të jenë bërë të gjitha verifikimet përkatëse nga *grupi i kontrollit të cilësisë* dhe rezultatet të kenë dalë pozitive, siç është parashikuar në kontratë dhe në dokumentin e *Specifikimeve Teknike*, *Policia e Shtetit* do të bëjë pranimin e produktit përfundimtar. Artikujt konsiderohen të pranuar vetëm kur plotësohen të gjitha kërkesat e *Specifikimeve Teknike*.

GARANCIA

Afati i garancisë duhet të jetë 1 vit për artikujt që e kanë afatin e përdorimit 1 vit dhe të paktën 2 vjet për artikujt që kanë afatin e përdorimit mbi 2 vjet. Në rastet kur artikulli pëson defekt si pasojë e mosrespektimit të kërkesave teknike të specifikuara në këtë dokument, Operatori Ekonomik duhet të sigurojë riparimin ose zëvendësimin e plotë të artikullit, pa pagesë, konform specifikimeve teknike në këtë dokument. Lëvrimi i mallit duhet të shoqërohet detyrimisht me deklaratën e garancisë. Afati i garancisë fillon në momentin e kolaudit.

AUTORËSIA

Specifikimet Teknike të artikujve të mësipërm janë pronë e Policisë së Shtetit dhe mund të përdoren vetëm nga strukturat e këtij institucioni. Kopjimi dhe shumëfishimi i Specifikimeve Teknike të këtyre artikujve është i ndaluar.

Dokumenti i Specifikimeve Teknike të kapitullit Xhrupa ka gjithsej 113 faqe.